

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-32

1-136

Xhafer i Martini



MEN GJES
PRILLI

TREGJIME



SH-52

136

XHAFERR MARTINI

MËNGJES PRILLI

tregime



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

RREMË SADRIA

Fshati Buzëdrinas shtrihet në rrëzë të malit të Nërëxës e të Nebeshinit. Dy malet sikur i kishin dalë për zot fshatit ta mbronin nga erërat dhe armiqtë. Buzëdrinasi është në kufi me shtetin e huaj dhe armiku e sulmonte shpesh. Ai ishte pushtuar disa herë, por kurrë për një kohë të gjatë. Fshatarët ngjiteshin në male dhe që andej e sulmonin pa ndërprerje armikun deri sa atij nuk i mbe-tej gjë tjetër veçse të tërhiqej nga kishte ardhur. Po një herë armiku sulmoi fare papritur dhe fshatarët nuk patën kohë të ngjiteshin në male. Mjaft familje ranë në dorën e tij. Ky ishte pushtimi i parë i vërtetë: pushtimi i tokës dhe i njerëzve. Vërtet ishin më shumë gra, pleq e fëmijë, por, përderisa këto ishin në dorë të armikut, atëherë u priteshin krahët dhe burrave në male. Armiku i kishte kërcënuar trimat në male, se po të vrisnin qoftë edhe një ushtar të huaj, do të ekzekutoheshin të gjithë banorët e fshatit, pa kursyer as fëmijët. Pushtimin e këtij fshati armiku e shihte si pikë strategjike, sepse ai do t'i shërbente si një portë për t'u futur në të gjitha fshatrat e tjera të tokës shqiptare. Armiku nuk sillej keq me banorët e mbetur në fshat, por burrat në male e dinin përse ai vepronte kështu. Ai kërkonte që buzëdrinasit të ruanin «asnjanësinë» e ta lejonin atë të futej më thellë në tokën shqiptare. Ishte vjeshtë e tretë dhe misrat po kalbeshin

në ara, ngaqë nuk kishte kush t'i korrte. Burrave në male u pikonte në zemër kjo gjë.

Dy burrat më të dëgjuar e më pleq të Buzëdrinasit, Rremë Sadria e Metë Veseli, po këshilloheshin në një shpellë të malit të Nebeshinit. Armiku u kishte dërguar fjalë që të zbrisnin të gjithë sa ishin në fshat e të fillonin punën, se askush nuk do t'i prekte. Ata ftoheshin të zbrisnin në fshat me gjithë armë e jo si robër. Armët nuk do t'i dorëzonin, veçse edhe nuk do t'i përdornin kundër pushtuesit. Dy pleqtë kishin më shumë se një orë që kuvendonin, por nuk po i jepnin zgjidhje punës.

— Hë, Rremë Sadria, po të dëgjoj, — i tha Meta.

Rrema ishte më plak. Metë Veseli ishte më i ri dhe pleqëria e të parit ia përkëdhelte sedrën e në cepat e buzëve i endej një buzëqeshje djallëzore. «S'e ke të gjatë, Rremë Sadria». Rrema ishte i pikëlluar, hidhërimi i tij kishte të bënte me gjendjen e fshatit. Shpeshherë ngrysej në fytyrë dhe, pas pak, rrinte i heshtur sikur të donte t'i jepte karar kësaj gjendjeje.

— Këtë gjë nuk e vendosim unë e ti, t'i mblidhemi të gjithë, — tha Rrema.

Metë Veseli u ngrit dhe thirri të tjerët, që ishin grumbulluar te shpella tjetër, pak më tej. Burrat hynin një nga një me pushkë në duar. Në një qoshe qëndronte Rrema, ulur mbi një rrasë. Burrat e përshëndetnin me respekt dhe uleshin. Shpella vende-vende pikonte. Pikat e ujit u binin mbi kokë, mbi supe, por askush nuk i vinte re ato. Pranë Rremës rrinte Metë Veseli. Të dy thithnin në qetësi llullat me duhan. Kushdo që i shihte e kuptonte se ata ishin të qetë vetëm në pamjen e jashtme.

— Armiku na ka dërguar fjalë të biem në fshat me armë. Armët nuk kemi për t'i dorëzuar. Me një fjalë, ne do të shohim punën tonë, ai të tijën. Hollë-hollë ai kurrë nuk ka dashur ta pushtojë Buzëdrinasin tonë, por ka da-

shur të shkojë më tej. Ne, deri tani e kemi penguar, po tani nuk mundemi. Në duart e tij kemi gratë dhe fëmijët. Nuk mund t'i biem kësaj radhe siç kemi bërë gjer më sot, — tha Metë Veseli duke i njohur kështu shkurtimisht burrat me rrethanat e krijuara. Burrat heshtnin. Askush nuk e ngrinte kokën se i dukej sikur do ta pyesnin të parin që të jepte mendimin e tij. Sytë i mbanin përdhe e buzët të kyçura.

— Po armët përse do të na duhen? — pyeti Rajtë Biba, një burrë i gjatë e korrozi. Metë Veseli e Rremë Sadria hodhën vështrimet mbi të. Po të dy këta burra e vështronin Rajtën nën prizëm të ndryshëm ndjenjash.

— Armët? Armët t'i kemi siç i kemi pasur gjithnjë, — tha Meta.

— Armët na duheshin për të luftuar armikun. Po në qoftë se nuk do të luftojmë, atëherë përse na duhen ato? — pyeti Rajta duke e vështruar në sy Metën.

Meta nuk e duroi dot vështrimin e rëndë të korroziut.

— Prandaj u mblodhëm, flisni, — u tha ai burrave.

Të flasë Rremë Sadria, — tha dikush.

Të flasë Rrema, — thanë shumë njerëz njëherësh.

Ata i kishin ngulur shikimet te plaku, ose më mirë të themi, ata shikonin buzët e tij. Rrema kapë pushkën që e mbante përbri dhe e vuri në prehër. Dorën e majtë e lëshoi lehtë-lehtë mbi tytën e ftohtë, kurse me të djathtën filloi të përkëdhelte kondakun e armës, sikur të ishte një fëmijë njomëzake. Burrat prisnin që ai të fliste, kurse Rrema vazhdonte të përkëdhelte pushkën. Sytë e tij u njomën. Pastaj papritmas drejtoi trupin dhe ngriti krenar kokën. Tani pushkën e kishte rrokur sikur po bëhej gati të hidhej mbi armikun.

— Kjo është përmbi çdo fjalë, — tha ai duke e tundur në ajër pushkën. — Kur nuk flet kjo, flet armiku si të dojë.

— Fjalë burrash, — tha Rajtë Biba.

— Fjalë burrash, — thanë dhe ca të tjerë.

— Fjalë burrash, por ne për gratë e fëmijët luftojmë.

Po t'u biem, ata do të na vrasin gratë dhe fëmijët. Unë them se nuk kemi rrugë tjetër veç të biem në fshat, — tha një fshatar.

— Kjo nuk është e mirë, po nuk kemi rrugë tjetër, — tha edhe Frrok Xhepi.

— Ashtu është, — foli dhe Martin Gjeta. — Kësaj radhe na ka kapur ngushtë hasmi dhe ne s'kemi ç'të bëjmë.

— Tani armiku kërkon të biem në fshat me armë. Pas tri ditësh ka për të kërkuar që të dorëzojmë armët, — foli sërish Rajtë Biba.

— Më mirë vdesim sot, — tha një malësor.

— Po gratë e fëmijët?

— Edhe ata bashkë me ne.

— Vdekja është kapak floriri.

Fjala mori zjarr. Shumë ishin ata që kërkonin t'i binin armikut, por ca më shumë ishin ata që donin të binin në fshat pa bërë pushkë për të shpëtuar gratë dhe fëmijët. Rremë Sadria u ngrit në këmbë dhe i nguli vështrimin e egërsuar të syve të tij syve dinakë të Metë Vesselit, që dukej tepër i gëzuar që shumica e malësorëve ishte e një mendjeje me të.

* * *

Kaluan dy javë që kur burrat ranë në fshat. Armiku nuk kërkoi të çarmatoseshin. Ai kishte ngritur çadrat buzë lumit të vogël malor, në të dalë të fshatit dhe dukej se nuk do të përzihej në jetën e fshatarëve. Por, pas dy javësh, komandanti armik urdhëroi fshatarët që të hapnin një rrugë automobilistike që të çonte në fshatin fqinj. Burrat u mblodhën te Fusha e Djerrun, ku do të hapej

rruga, po me armë në sup e jo me kazma e lopata. Ata bënë një gardh të dendur supesh dhe tyta pushkësh që zgjateshin përmbi supe, paralel me kokat e tyre. Përballë tyre qëndronin oficerët dhe ushtarët armiq. Oficerët u këshilluan një copë herë me njëri-tjetrin. Fshatarët s'kishin ç'të thoshin. Pushkët në vend të veglave flisnin më shumë se gjithçka. Midis tyre, si një lis degëgjërë, rrinte Rremë Sadria, i cili zotëronte mbi tërë burrat me pamjen e tij të rëndë. Ajri i mëngjesit, duke u ndeshur në frymën e tij të ngrohtë, formoi në mustaqet e tij një shtresë të hollë akulli dhe mustaqet i dukeshin si stalaktite. Ashtu i gjatë, me shpatulla të gjera, me këmbë të gjata si të gdhendura nga drurët e gjatë të pishave, me kollanin me dy radhë fishekë, me pisqollën në brez dhe pushkën e gjatë në dorë, ai dukej si një kreshnik i dalë nga legjendat. Metë Veseli qëndronte në të majtë të tij, disi mënjane, i heshtur dhe i ngrysur.

— Ju thamë që të vinit me kazma e lopata e jo me pushkë, — u tha fshatarëve njëri nga oficerët e huaj, i cili e fliste mirë shqipen.

— Ne nuk punojmë për ju. Kjo rrugë neve nuk na duhet, — tha prerë Rremë Sadria.

Oficeri ia përktheu komandantit fjalët e fshatarit buzëdrinas. Komandanti tundi kokën dhe qeshi me ligësi.

— Duhej filluar ndryshe, duhej filluar nga armët, — u tha ai oficerëve.

Pastaj seç i foli në gjuhën e tij oficerit që dinte shqipen dhe ky i fundit u tha fshatarëve:

— Mirë. Ne kërkuam vetëm një ndihmë të vogël nga ju.

Burrat po ktheheshin për në fshat. Ata e kuptonin se armiku u lëshoi rrugë vetëm ngaqë nuk kishte se ç'të bënte. Metë Veseli u lëshoi dorën mustaqeve dhe tha me mburrje:

— Mirë ua bëmë. Tani nuk na bien më në qafë.

Rremë Sadria, sa dëgjoi këto fjalë, u ndal. Edhe burrat e tjerë që ecnin pas tij, u ndalën. E gjithë kjo masë njerëzish që u ndal papritmas, u duk sikur mbajti këmbët që të mos binin në humnerë.

— Unë ç'ash e ti ç'ash, po katruven kush e mbush? — pyeti Rema me egërsi Metë Veselin.

— Ç'do të thuash? — foli me qetësi të shtirë Meta.

— S'e kupton se ç'dua të them? Mirë atëherë, armiku tani do të kërkojë që ne të dorëzojmë armët.

— Jo, he burrë, ai tani nuk guxon të futet në fshat.

— Guxon që ç'ke me të.

— Ata na kanë pushtuar dhe ju thoni se nuk guxojnë të futen në fshat.

— Fshati i tyre është.

— Fshati është yni. Po të mos na e kishin frikën, nuk na linin sot të iknim pa u bërë rrugën.

— Prit, se ke për të parë.

Mendimet e njerëzve prapë u ndanë.

Pas ca kohe armiku filloi të lëvizte e të afrohej gjithnjë e më pranë fshatit. Një mëngjes fshati u gdhi i rrethuar nga të gjitha anët. Rrugët për në malin e Nërës e të Nebeshinit ishin zënë nga forca të shumta armike. Komandanti i ushtrisë së huaj urdhëroi burrat që të mblihdeshin te Rrapi i Fatos në mes të fshatit.

— Burrat te Rrapi i Fatos!

Kjo thirrje e zgjoi atë mëngjes më herët se zakonisht Rremë Sadrinë. Ai u ngrit dhe iu afua dritares së vogël. Pa fshatarët që po shkonin një nga një te Rrapi i Fatos. Plakut i pikuan lotët dhe i ranë në mjekër. Ata që qajnë rrallë, thonë që kanë lotë shumë të hidhur. Dhe Rremë Sadria kishte pesëdhjetë vjet që nuk kishte qarë.

— Burrat te Rrapi i Fatos! — bërtiste tellalli i fshatit, Bexheti. Rrema e dinte se kjo ditë do të vinte, por tani

që erdhi vërtet, ishte një gjë shumë më e hidhur nga ç'e kishte kujtuar ai. Ç'i kujtonte plakut ai rrap?! Mbase është i vetmi rrap që ka emrin e një femre, të një vajze.

... Atëherë Rrema ishte i vogël. Edhe atëherë ky armik shkeli fshatin e tyre. Fshatarët luftuan me trimëri dhe armiku u egërsua shumë. Ai mundi ta pushtonte përkohësisht fshatin. Komandanti i tyre dha urdhër që të bëhej masakër. Burrat i vunë pas rrapit dhe i pushkatuan. Po atëherë rrapit nuk kishte emër. Kjo gjë ndodhi më vonë. Fatoja ishte vajza më e bukur në fshat. Një oficer i huaj e pa atë në krua dhe dalldisi pas saj. Iu sul vajzës, e rrëmbeu pas beli dhe e puthi. Gazi mbeti për oficerin dhe ushtarët e tij, kurse turpi për Faton dhe për fshatin. Fatoja qau natë e ditë pa pushuar asnjë çast. Qau dy javë me radhë. Gjatë kësaj kohe as nuk hëngri as nuk piu. U bë koskë e lëkurë. Po ta shihje, nuk të shkonte kurrë ndër mend se ishte ajo Fatoja që lëshonte dritë nga shkonte. Njerëzit thoshin se ajo u çmend. Vërtet hidhërimi të çmend, por atë nuk kishte asnjë forcë në botë që ta çmendte, ose që ta çonte në varr. Ajo tanimë jetonte për t'u hakmarrë. Dëshira për t'u hakmarrë ndaj oficerit që e turpëroi në mes të fshatit i hyri në çdo qelizë të trupit. Ajo tanimë ushqej me këtë dëshirë dhe ishte kjo që e mbannte gjallë dhe nuk e linte të çmendej e të vdiste. Se nga gjeti Fatoja një revolver dhe një ditë, kur oficeri po sillej rrugëve të fshatit si kapadai, ajo i doli para dhe i tha: «Ky është nderi im», — e ia numëroi shtatë plumbat në gjoks. Ai u lëkund dhe ra në pellgun e gjakut të tij, kurse ushtarët u hutuan. . . Fatoja qëndroi për disa çaste si e ngrirë, pastaj ajo shikoi qiellin e kaltër dhe buzëqeshi. Ushhtarët pas pak u përmendën dhe panë se ajo që shtriu për tokë oficerin ishte vajza që po qeshte para tyre. E kapën vajzën dhe e rrahën egërsisht. Në mëngjesin e ditës tjetër e varën te rrapit që ta shihte tërë fshati. Dhe fshatarët

shkuan jo për të bërë sehir, po për të qarë Faton, trimëreshën e tyre. Burrat pinin duhan që të mbanin lotët, kurse gratë qanin. Gjylja, vajtuesja e fshatit ia mori me zë të lartë e të dredhur:

*«Fato, moj luleborë,
lule qe, lule shkove,
zabitit ia numërove,
nderin tënd e shpëtove...»*

Frynte erë dhe degët e rrapit tundeshin. Pas Gjyles ia morën edhe gratë e tjera. Ajo nuk ngjante më me një këngë vaji, por me një këngë lufte. Që atëherë rrapit u quajt «Rrapi i Fatos».

* * *

Burrat e fshatit kishin më shumë se një gjysmë ore që ishin mbledhur te Rrapi i Fatos. Pleqtë pinin duhan në heshtje. Komandanti i ushtrisë së huaj priste nja dyqind hapa larg tyre, nën hijen e një ftoi, për të mbledhur armët. Ai u kishte thënë fshatarëve që t'i grumbullonin ato e t'i dorëzonin brenda dy orëve, dhe, në qoftë se nuk e bënin këtë, u kishte lënë të kuptonin se do t'i çarmatoste me forcë. Rremë Sadria ende nuk po dukej te Rrapi i Fatos dhe afati që kishte dhënë oficeri i huaj po mbaronte.

— Të vijë Rremë Sadria? Si harruam të pyesim Rremë Sadrinë?! — pyeti tërë zemërim Rajtë Biba duke vështruar me përbuzje Metë Veselin.

— Si erdhi, si nuk erdhi Rrema, njësoj është. Armët duhen dorëzuar se armiku na ka rrethuar, — tha Metë Veseli.

— Armët i duhen kthyer armikut! — u hodh i inatosur Rajta.

— Po të kishim forca do t'ia kishim kthyer me kohë,
— u përgjigj ftohtë Metë Veseli.

— Kështu është, — foli dikush.

— Na fute në bata, o Metë Veseli, qysh kur ngule këmbë që të zbrisnim nga malet. Na the se nuk na nget armiku, e sikur ai kishte ardhur këtu për të mirën tonë. E si të mos mjaftojnë këto tani, na thua që të dorëzojmë armët, nesër kushedi se ç'do të na thuash, — tha me urrejtje të thellë Qazim Dylli.

— Po s'kemi çfarë të bëjmë, o mixha Qazim. Nuk kemi gjë në dorë, — u përpoq ta zbuste Metë Veseli.

— Po vdekjen a e kemi në dorë, ë? Të vdesim, — tha plaku.

— Të thërrasim Rremë Sadrinë, të dërgojmë e ta marrim, — tha dikush.

— Rremë Sadrinë, Rremë Sadrinë! — thirrën të gjithë.
Rajtë Biba u nis për te Rremë Sadria.

— Nuk kemi përse e presim. Po pranuan ata (dhe ai bëri me kokë nga oficerët e huaj), unë them që të dorëzojmë vetëm pushkët e të mbajmë patllaket, — tha Metë Veseli.

— Mendim i mirë, — miratoi Nazif Refa, që tërë kohën i kishte mbajtur ison Metës.

— Nuk do të quhemi pa armë, — ndërhyri prapë Meta.

— Të presim Rremë Sadrinë, — tha Qazim Dylli.

— Unë nuk e dorëzoj pushkën i gjallë, — tha një djalë i ri.

— As unë!

— As unë!

— Ç'do të bëni? A nuk e shikoni që jemi të rrethuar nga një ushtri e tërë dhe nuk kemi veçse nga një ballë fishkë, — iu drejtua Metë Veseli atyre që folën.

— I shitur, — i tha Metë Veselit një tjetër.

— Burra, bëni si të doni! Në qafë paçi vete, — u

tha ai malësorëve. Në këto çaste komandanti i ushtrisë së huaj po vinte i shoqëruar nga dhjetë oficerë. Sa u afrua te Rrapi i Fatos, ai i përshëndeti lehtë me kokë malësorët dhe shikoi orën, sikur deshi t'u thoshte «Hë, si vendosët?!»

— Ne menduam të dorëzojmë pushkët e të mbajmë patllaket, — tha Metë Veseli. — Nuk dimë si thoni ju. Malësorët e kanë shumë të vështirë t'i dorëzojnë të gjitha armët menjëherë.

Oficeri që dinte shqip përktheu fjalët e tij. Në fytyrën e komandantit të ushtrisë së huaj u shqua një buzëqeshje e lehtë, duket atij i pëlqeu propozimi i Metë Veselit, por me qëllim e vonoi ca përgjigjjen. Pastaj seç i tha oficerit që dinte shqip.

— Komandanti pranon! Të fillojë dorëzimi i pushkëve! — tha oficeri shqip.

Në këtë kohë te Rrapi i Fatos u duk Rremë Sadria. Të gjithë burrat kthyen kokën nga ai. Ai ecte i qetë me hapin e tij të ngadaltë. Pranë tij ecte Rajtë Biba. Rrema e kishte hedhur pushkën në sup me tytë lart dhe patllaken e kishte vënë në brez. Pleqtë e kuptuan përse e kishin të vënë pushkën me tytë lart ai. . . Kur u afrua te Rrapi i Fatos, burrat u ngritën në këmbë. Ai i përshëndeti me një buzëqeshje të lehtë.

— Ne ia vumë shtrazën mullarit, — i tha atij Metë Veseli.

Rrema heshti. Pastaj hodhi një vështrim mbi të gjithë dhe në fund i ndali sytë te Metë Veseli:

— E, si e vutë? — pyeti ai Metën. Kësaj here përçmimi dukej qartë në sytë e plakut.

— Dhamë të gjatat e mbajtëm të shkurtrat. — tha Meta.

— Nuk e paski vënë shtrazën mirë. Kështu pikon mullari, — tha Rremë Sadria.

Fshatarët, që deri atë çast ishin si në gjemba, ia ngulën sytë me admirim plakut. Oficeri që dinte shqip ia përktheu menjëherë komandantit, por ai nuk kuptoi asgjë nga ky bashkëbisedim.

— Ç'të bëjmë? Përse nuk paskemi vepruar mirë? — iu hakërrye atij Meta.

— Po dorëzove të gjatat, të shkurtrat zëre se nuk i ke. E gjata e ruan të shkurtrën, — shpjegoi Rremë Sadria. — Të kujtohet Fatoja ty, o Metë Veseli, apo nuk të kujtohet? E pra ne jemi te Rrapi i saj, — dhe Rrema i ktheu krahët atij .

— Rroftë Rremë Sadria! — bërtitën burrat.

— Rroftë Rremë Sadria!

Rrema si vetëtimë hoqi pushkën nga supi dhe ia drejtoi komandantit të ushtrisë së huaj, i cili nxori me të shpejtë revolverin dhe ia drejtoi Rremës, por nuk mundi ta qëllonte, se më parë u dëgjua krisma e armës së Rajtë Bibës që ia flaku komandantit armën nga dora. Atëherë burrat u sulën mbi oficerët e tjerë dhe i çarmatosën. Robërit u zbehën. Ata kujtuan se malësorët do t'i ekzekutonin menjëherë. Komandanti i ushtrisë së huaj mallëkoi veten që mori me vete tërë oficerët, duke e quajtur punë të mbaruar çarmatosjen e malësorëve.

— Po të doni të shpëtoni, u jepni urdhër ushtarëve që të largohen përtej kufirit. Ndryshe jeni të mbaruar me gjithë ushtri, — u tha atyre Rremë Sadria.

Oficerët panë njëri-tjetrin, pastaj i hodhën sytë tek ai që pak çaste më parë ishte komandanti i tyre. Vështrimet e tyre u kryqëzuan dhe të gjithë sikur e gjenin me vend propozimin e këtij plaku të çuditshëm që i çarmatosi papritur. Metë Veseli dhe Nazif Refa mbetën si të veçuar nga grupi i malësorëve që kishin rrethuar Rremë Sadrinë.

HENDEKU KLASOR

Në dimrin e vitit 1943 në fshatin Bardhaj ra borë e madhe. Fshati u izolua nga fshatrat e tjera, e shtëpitë u ndanë nga njëra tjetra. Binte borë vazhdimisht. Veriu i fortë që frynte pa pushuar as ditë, as natë, e sillte dhe e pështillte borën duke krijuar kodrina të vogla të bardha. Ziheshin shtigjet dhe rrugët, ishin zënë dhe dyert e shtëpive. Madje kishte raste që shtëpitë përdhese mbuloheshin krejtësisht nga bora. Njerëzit i mbanin kazmat dhe lopatat pranë pushkës, në dhomën ku rrinin, se herë pas here u duhej të pastronin murin e borës që formohej mu përpara derës së shtëpisë. Kur bora rrëshqiste për pak kohë dhe nuk frynte veriu, burrat e fshatit mblidheshin te Lëndina e Madhe me kazma e lopata në duar dhe hapnin rrugët për të shpënë bagëtinë për të pirë ujë në përrua, apo për në mulli. Tri ditë e tri net qe kjo kohë. Të katërtën ditë moti sikur u hap ca: as nuk frynte, as dëborë nuk binte. Kjo ditë i gëzoi fshatarët, të cilët vraponin te njëri-tjetri më shpesh për të parë si i kishin halllet komshinjtë. Natyra i afroi edhe më shumë njerëzit njërin me tjetrin.

Xha Brahoja, pasi bëri disa vizita te komshinjtë më të afërt, mbylli portën e shtëpisë duke thënë ato fjalë që kishte më se dy javë që i përsëriste çdo mbrëmje: «Ditë e re, nafakë e re!»

Hyri në dhomën e tij përdhese ku e shoqja, Hyrija dhe nusja e djalit të vetëm, Azemit, përpiqeshin të ndiznin zjarrin që qe shuar.

— Tfu! Dimër i mallëkuar! As zjarri nuk ndizet, — mallëkoi plaku si u ul në hasrën e shtruar pranë oxhakut.

— Baba, ta ndezim edhe sobën? — e pyeti e reja.

— Ky drej oxhak nuk po tërheq tymin e vatrës e jo më të shtojmë edhe të sobës. Fry e pështy u shkoi koha, — briti plaku.

— Edhe ti mos u qaj, se brenda je. Po Azemi me shokë ku janë, — i tha Hyrija.

Xha Brahoja nuk u përgjigj menjëherë, ndaj Hyrija mendoi se e zuri ngushtë plakun. Po Xha Brahoja nuk ia linte tehun mbarë së shoqes.

— Mos më trego partizanët mua ti. E di unë ç'është lufta. I kam provuar të tëra unë, edhe të ftohtin, edhe urinë. . . Po në pleqëri s'u mbakan dot, qenkan të rënda. Po na ngordh bagëtia për një dorë kashtë, vetë nuk kemi një dorë miell, dru nuk kemi.

Pastaj ai nuk foli. Ndezi një cigare duhan dhe ra në mendime. Duhej edhe një muaj që të mbushej viti qysh kur Azemi doli malit partizan. Brahoja e kishte pikasur prej kohësh që i biri diç i fshihte, dhe priste që ai t'i hapë vetë. . . Dhe kjo ndodhi atë mëngjes të ftohtë dimri. . . Brahoja me Azemin kishin rrokur sëpatat dhe po prisnin një rrap të madh se u qenë mbaruar drutë. Ata iu vunë punës dhe babë e bir, brenda gjysmë ore e rrëzuan rrapin e madh.

— Ulu pak ti, baba, e ndize një, se vazhdoj unë, — i tha Azemi plakut. Brahoja u ul dhe e ndezi. Ai shikonte me dashuri të birin, i cili në atë të ftohtë të madh punonte vetëm në këmishë. Ai e godiste me forcë drurin dhe sëpata rrasej si në kungull. Djersët i shkonin rrëke nga balli, dhe xha Brahoja u gëzohej llërëve të tij të fu-

qishme, shpatullave të gjera, gjoksit leshtor që i ulej dhe i ngrihej pa pushim nga një frymëmarrje e fuqishme. Djali punonte pa e ngritur kokën dhe plaku vuri krahas saktësisë dhe mjeshtërisë të të goditurit edhe një farë zemërimi. Sa herë që godiste drurin me sëpatë, nga gjoksi i Azemit dilte një gulshimë e gjatë...

— Pusho pak, Azem, — foli plaku.

Azemi e la sëpatën dhe u ul pranë t'et, në ashklat e rrapit. Ndenjën një copë herë pa folur.

— Kam menduar diçka, babë, po nuk di si do ta presësh ti, — i foli t'et i biri duke e vështruar në sy.

— Unë nuk kam bërë djalë që të mendojë keq, — u mburr ca xha Brahoja dhe i hodhi krahëve të birit xhaketën që të mos ftohej.

Nga fjalët e t'atit Azemit i qeshën sytë: ai e kuptoi se ishte çasti më i përshtatshëm për t'ia thënë.

— Dua të dal partizan, babë. Nuk durohet kjo jetë që bëjmë. Partizanët po luftojnë, por, ai i cili do që liria të vijë sa më shpejt, duhet të bashkohet me ta.

Xha Brahoja nuk u përgjigj menjëherë, thithi dy-tri herë llullën duke nxjerrë fjolla të bardha tymi.

— Mirë ke menduar, bir, po kur?

— Të hënën, babë!

Xha Brahoja u përmend se që e shtunë. Me një fjalë, pas dy ditësh, mendoj ai dhe e përfshiu me një vështrim ledhatues të birin.

Të hënën që në mëngjes xha Brahoja e përcolli të birin për në malin e Xhernit. Xha Brahoja u nda me të birin dhe e ndoqi me sy i strukur në lisat e dushkut, te Murrizi. Pushkën e shkurtër italiane ai e mbante nën kapotën e vjetër ushtarake.

— Ti do të gjesh pushkë, Azem, po unë plaku nuk kam ku gjej. Kjo më duhet për ditë të zeza, — i tha ai të birin, kur u ndanë.

Ashtu i strukur në lisat e Murrizit, xha Brahoja vuri re se tre burra Perkolasi i dolën para të birit dhe ndalën. Njëri nga ata kishte një sëpatë në dorë, siç dukej ata kishin dalë herët për të prerë dru.

— Ku po shkon, o i biri i Brahos? — e pyeti njëri.

— Në punën time, — u përgjigj Azemi dhe nuk e ndali hapin.

— Më duket se po shkon t'u çosh bukë partizanëve, ë? — e pyeti me kërcënim ai që mbante në dorë sëpatën.

— Po, — u tha Azemi me zë të lartë e me të njëjtin ton kërcënues, siç i folën ata. — Po u shpie bukë e do të rri edhe me ta.

— Kjo sëpata ime s'ka me të lanë, — tha ai që mbante sëpatën dhe iu afrua. Edhe dy të tjerët iu afruan. Azemi u ndal. «Bir, mos i bjer askujt në qafë, por, po të ranë, ngul këmbët e qëndro si burrë». Azemi lëshoi trastën përdhe dhe u bë gati të kacafytej me ta. Ai që tani ishte partizan dhe partizanët nuk dorëzohen.

Në këto çaste xha Brahoja ishte tërhequr pa u vënë re dhe u doli në krah Perkolajve. Nuk ishte më shumë se dhjetë hapa larg tyre e të birit, kur thirri:


— Hë, pa prekeni, — dhe u drejtoi pushkën. Ata u zverdhën kurse Azemi u çudit se nga mbiu plaku. Ai kishte menduar se i ati kishte mbërritur në shtëpi.

— Prekeni! Përse u ndalët? — u tha ai atyre.

— Ne donim të bënim shaka, ai e ka të lirë rrugën, — tha ai që mbante sëpatën në dorë. Perkolasi u tërhoqën të turpëruar.

— Faleminderit, baba! — i tha Azemi, i cili, pasi bëri nja dy-tre hapa, shtoi: — Janë qenër këta, do t'i tregojnë Din Halilit dhe kam frikë se mos ju ndodhë gjë juve, — tha djali kur u përshëndosh për së dyti me të atin.

— Le t'i tregojnë, — tha Brahoja shkurt, dhe ngjeshi pushkën në brez.



...I përkundur në këto kujtime, plakun e zuri gjumi. Fjeti keq dhe pa shumë ëndrra. Ndërsa kishte humbur në ëndrën ku iu shfaq Azemi, e zgjuan disa të trokitura në derë. Ai hapi sytë dhe kuptoi se mëngjesi donte edhe një orë që të vinte. Të trokiturat dëgjoheshin gjithnjë e më pak.

Xha Brahoja u besonte ëndrrave. Ai kishte dëgjuar se ëndrrat që i shikon afër mëngjesit realizohen shpejt. Mendja i vajti te Azemi.

— «Mos vallë është ai», — mendoi plaku dhe u rrotullua në shtrojen e tij për t'u ngritur. Po e reja u ngrit para tij dhe deshi të hapte derën.

— E hap unë, nuse! Natën vetëm burrat e hapin derën, — tha plaku dhe u ngrit. U vesh me nxitim. Të trokiturat në derë nuk po dëgjoheshin më. Xha Brahoja doli e hapi derën. Nuk pa njeri. Në gjysmerrësirë po përpiquej të dallonte gjë, por ishte e kotë.

— Kush është? Kush trokiti? — pyeti ai.

Atëherë dy hije u afruan.

— Xha Braho, jemi ne, shokët e Azemit, mos u tremb. Kemi sjellë një shoqe të plagosur. Meqenëse nesër do të nisemi, kjo shoqe s'na ndjek dot, gjendja e saj u keqësua. Ka dy ditë që është plagosur në përpjekje me forcat e Din Halilit, menduam se do ta shëronim në kompani, po s'qe e thënë. Tani po ta lëmë ty në kujdesje, — dhe, si e vendosën të plagosurën brenda, dy partizanët shkuan.

— Bija e nënës, si qenka katandisur! — tha Hyrija.

— Gjak? Plagën e paska në shpatull, — tha xha Brahoja duke u përkulur mbi partizanen për t'i hapur xhaketën e vjetër. Nga të ftohtit plaga i kishte kulluar aq shumë gjak, thujse qe plagosur atë çast. Atij po i dridheshin duart dhe diçka si një lëmsh i vogël i mblodh në fyt. Lëshonte duart me kujdes në shpatullën, koskë e lëkurë

të partizanes dhe ndiente se po i therte në shpatull, plumbi që i kishte mbetur që nga lufta e 1920-ës, kur hodhën Italinë në det.

— Afro kandilin, — i tha ai nuses. Nga të ftohtit partizania ishte zverdhur aq shumë, sa të linte përshtypjen e një të vdekuri.

— Mos u mërzit, bijë e nënës, shpejt do të të shërojmë ne, — i fliste nënë Hyrija që, përkulur mbi partizanen, i lëmonte flokët, si bënte dikur me Azemin kur ishte i vogël. Xha Brahoja ktheu kokën nga dritaret e vogla të dhomës së tij përdhese. Vuri re me shqetësim se drita me fasha të bardha po depërtonte midis të çarave të kanatave dhe sajonte diçka si të prerë shpate në murin e nxirë të dhomës. Hyrija e nusja nuk kuptonin përse ai humbiste kohë duke vështruar nga dritaret e nuk nxitonte për të mjekuar partizanen.

— Hë, ore, mjekojë vajzën! U bëre zemërpulë, — i tha Hyrija të shoqit duke e tundur për krahu.

— Ti di vetëm një, dhe njëqind të tjerat i harron, — iu gërmush plaku asaj.

Nuses i vinte inat kur ziheshin vjehrra dhe vjehri, sidomos tani asaj po i vinte plasja, «e gjetën kohën për t'u grindur dhe këta».

— Merruni ju me të. Mjekojeni si të mundeni. Unë po dal, — tha xha Brahoja.

— Ku shkon, baba? — e pyeti nusja.

— Te Shabani. Partizanes me siguri i ka rrjedhur gjak gjatë rrugës. Gjaku në dëborë është si boja e kuqe në letrën e bardhë. Duhet mbuluar gjurmët, se vjen çeta e Din Halilit dhe na e gjen këtu, — shpjegoi plaku.

Plaku kishte të drejtë dhe në sytë e plakës tani lexohej pendimi.

— Mirë, shko ti, shko. Vajzën do ta mjekojmë ne, — tha Hyrija.

Xha Brahoja doli nga shtëpia. Shkuli me zor një hu në gardhin që mezi dukej nga dëbora dhe u çapit në rru-gë. U rrëzua disa herë derisa arriti te shtëpia e Shaban Sadikut. Goditi tri herë në dërë me hurin që mbante në dorë. Brenda në shtëpi u ndie një lëvizje. Brahoja ndjeu kollën e thatë të Shabanit që s'po i ndahej prej kohësh.

— Hë, Braho, ç'kemi. Futu brenda, — e ftoi Shabani.

— Nuk kam ardhur për të ndenjor, — tha Brahoja dhe i tregoi shpejt e shpejt se çfarë kishte ngjarë.

— Ke të drejtë. Duhet fshehur gjurmët se tani po gdhin e Din Halili me njerëzit e tij mund të bien në gjurmë, apo s'janë ata Perkolajt. Të poshtë e treguan veten, — tha Shabani i menduar.

— Qenët, — shfryu xha Brahoja dhe shikoi nga kreu i fshatit, atje ku ishin shtëpitë e Perkolajve.

Dy burrat po rrinin të menduar në të ftohtin e atij mëngjesi dimri. Ata vështronin të dy përdhe, në dëborën që kishte ngrirë gjatë natës, pa mundur të gjenin një zgjidhje.

— Po gdhin dhe, për fat të keq, nuk po bie dëborë, — tha Shabani i trishtuar.

— Dëborë do të bjerë, po pas nja dy orësh. Po gjer atëherë...

— Ashtu vërtet, mali i Nebeshinit nuk duket fare nga mjegulla. Është shenjë e sigurtë. Po si t'ia bëjmë gjer atëherë? — pyeti Shabani.

— Sa njerëz të besuar kemi në fshat?

— Të besuar? Po ti i njeh si unë, o Braho. Me Parti-në janë të gjithë, me përjashtim të atyre zagarëve të Din Halilit. Nuk na tradhton njeri nga këta, po thuaj çfarë mendon, — foli Shabani.

— Të dalim tërë burrat e fshatit me lopata në duar, sikur po hapim rrugën për në mulli. Partizania ka ardhur nga rruga që të çon te mulliri, — tha Brahoja.

— Nga e di se ka ardhur që andej?

— Më thanë ata që e shoqëronin.

Shabani u mendua paksa për propozimin e Brahos, pastaj tha:

— Mirë e ke menduar. Të lajmërojmë menjëherë fshatin. Ti bjeri andej nga Stafajt, kurse unë po i bie këndeje nga Dervishajt. Mblidhemi e fillojmë punën para shtëpisë sate.

Pas gjysmë ore pesëmbëdhjetë burra me lopata në duar ndodheshin para shtëpisë së Brahos dhe filluan të hapnin rrugën. Dy burra të rinj nxitonin nja dhjetë hapa para të tjerëve për të mbuluar gjurmët, kurse të tjerët thellonin rrugën duke ngrënë në të dyja anët shtresën e trashë të dëborës. Dëbora, megjithëse kishte ngrirë gjatë natës, pritej me lehtësi me lopatë. Shpejt u hap një rrugë e ngushtë këmbësore midis mureve të trasha e të bardha të dëborës. Ajo rrugë ngjante më tepër me një kanal të bardhë. Mbeteshin dhe rreth pesëdhjetë hapa për të mbërritur te mulliri, kur ja, me lopata në duar, u dukën të dilnin nga shtëpitë e tyre gjashtë burrat e Perkolajve. Nxitonin drejt burrave të fshatit krenarë e nervozë. Kishte kohë që qe krijuar një farë ndarjeje ndërmjet burrave të fshatit e Perkolajve, nuk kishin të hyra e të dala me ta as për gëzim e as për hidhërim, nuk i thërrisnin në mbledhje dhe as në punë të përbashkëta. Ç'kishte ndodhur midis tyre? Midis fshatit e Perkolajve ishte hapur një hendek i thellë, hendeku klasor, ata ishin radhitur në anë të kundërta; Perkolajt bashkëpunonin fshehurazi me bandën e Din Halilit, kurse fshati ishte me partizanët. Çdo ditë e më tepër hendeku midis fshatit e Perkolajve thellohej, çdo ditë e më tepër armiqësia midis tyre shtoej. Ishte një armiqësi e pashpallur, por e thellë dhe e egër. Në rastin më të parë ajo do të shfaqej e do të pohohej me tërë forcën.

— Pse nuk na thirrët edhe ne për të hapur rrugën, o Shaban? — pyeti më i vjetri i Perkolajve, i cili qe afruar pranë grumbullit të burrave që punonin.

— Nuk është nevoja, jemi boll, — tha ftohtë Shabani, pa e parë në sy atë që foli. Tani pranë atij që foli qenë afruar edhe Perkolajt e tjerë. Ata rrinin të zymtë e hijerëndë matanë kanalit të bardhë të dëborës. Të gjithë e ndienin se do të zhvillohej një dialog i ashpër dhe i ftohtë, me fjalë të rënda. Ky dialog do ta shpallte hapur grindjen midis fshatit e Perkolajve. Tani rruga e hollë këmbësore, hapur në dëborë, që ndante Perkolajve me burrat e fshatit, dukej sikur po zgjerohej, po zgjerohej vazhdimisht, duke i larguar ata gjithnjë e më shumë nga njëri-tjetri. Hendeku i thellë klasor po merrte një formë konkrete në atë udhë dëbore që hapej për të mbuluar gjurmët e gjakut partizan, që kishin mbirë si lulëkuqe në të... Burrat e fshatit mendonin se në themel të grindjes e të ndarjes së tyre me Perkolajt ishin pikërisht ato gjurmë gjaku që përpiqeshin t'i fshihnin...

— Dëgjo, Shaban, ne jemi një fshat. Edhe ne, Perkolajt, bluajmë në mulli, prandaj edhe ne do ta hapim rrugën që na takon. Nuk bën mirë që na ndan nga fshati, — tha përsëri ai i Perkolajve.

— Ju vetë jeni ndarë nga fshati me kohë dhe kërkoni të bashkoheni me rrugën e mullirit. Kur na ndajnë rrugë të tjera, rruga e mullirit s'na bashkon dot, — tha me ton shpotitës Shabani, duke e vështruar në sy. Perkolajve.

— Nuk e di për ç'rrugë bën fjalë ti, o Shaban, po unë e kam fjalën për rrugën e mullirit.

— E di ti, e di, — foli kësaj radhe Brahoja. — Tani që po i rrëshqet toka nën këmbë Din Halilit, tani na hiqesh sikur qenke me fshatin.

— Pusho ti, Braho Muça, se nuk kemi punë me ty, — tha njëri nga Perkolajt.

— Kam unë punë me ju, ka fshati punë me ju, — tha Brahoja duke iu hakërryer atij që foli.

— Mirë, mirë, ne kemi ardhur të punojmë e jo të grindemi, — tha më plaku i Perkolajve.

Perkolajt, ashtu grup siç ishin, nxituan që të fillonin punën më larg burrave të fshatit, pranë dy të rinjve që po i afroheshin mullirit duke mbuluar me shpejtësi gjurmët. Po të bënin edhe disa hapa përpara, Perkolajt do ta kuptonin shkakun e vërtetë të kësaj pune. Ata po nxitonin buzë udhës së hapur në dëborë. Fshatarëve gjurmët e gjakut në dëborë tani u ngjanin si trëndafila të kuq. Ata nuk do t'i linin Perkolajt t'i shkelnin këta trëndafila të kuq që kishin mbirë në dëborë. Sikur t'u kishte dhënë kush komandë, ata e lanë punën, nxituan dhe u dolën Perkolajve përpara, të vendosur që të mos i linin të bënin qoftë edhe një hap më tej.

— Nuk kemi nevojë për ju, e hapim vetë rrugën, — u tha me ton urdhërues Shabani.

— Ne nuk kthehem, — thanë njëzëri ata duke hedhur edhe disa hapa. Tani burrat e fshatit qenë afruar pranë tyre duke i ngushtuar si në krahët e një dare.

— Ndaluni, — u bërtiti Perkolajve me sa fuqi që kishte xha Brahoja. — Shkoni e pregatisni dreka e darka për Din Halilin.

— Mbylle gojën, Braho Muça, se, për nder, ta ndava kokën më dysh, — tha njëri prej Perkolajve duke ngritur lopatën.

— Nuk je aq trim. Pa provoje njëherë, — i tha Brahoja atij.

— Provoje, në ta mban, — thirrën burrat e tjerë të fshatit duke ngritur lopatat.

— Ju qenkeni bërë gati kundër nesh, qenki bërë kra-

hu i këtij leckamanit, Braho Muçës, — tha njëri nga Perkolajt, duke ndërruar ton tashmë që e pa davanë të humbur.

Pastaj ata u kthyen nga kishin ardhur, të vranët e kokëvarur. Fshatarët nuk e hapën rrugën deri te mulliri se filloi të binte dëborë.

— Nuk është nevoja të punojmë më. Dëbora do ta mbulojë gjakun, — tha xha Brahoja.

Xha Brahos i pëlqeu që mbi gjakun e partizanëve po binte dëborë e re. Atij i dukej që gjaku i partizanes aty nën dëborë nuk do të tretej kurrë, nuk do ta humbte ngrohtësinë.

Burrat u kthyen në fshat. Ata ecnin njëri pas tjetrit midis mureve të trasha të dëborës. Mbi supet e tyre binte dëbora e re. Para shtëpisë së xha Brahos ata u ndalën. Plaku hyri brenda dhe, pas pak, doli që andej i gëzuar.

— Rron, — u tha ai atyre që pati më pranë.

— Rron!

— Rron!

— Rron! — e pasuan këtë fjalë të tjerët gjer te më i fundit.

FILIZI

— Niko! Niko!

Djali e kuptoi se po i thërriste i ati dhe bëri përpjekje të madhe për ta larguar gjumin që ia mbyllte me një dorë të padukshme qepallat. Ai i hapte me mundim sytë, po ata përsëri i mbylleshin shpejt, dhe e rrëmbente ëndrra që e kishte pushtuar tërë natën. Nikos i dukej se, ja, mu përpara shtëpisë së tij ishte ngritur një shkollë e re, e bukur, ku hynin e dilnin nxënës e mësues. Zilja e mësimit i ftonte nxënësit për t'u futur nëpër klasa dhe... Nikoja zgjohej. Nuk ishte zilja e mësimit po zilka e mushkës që kulloste në oborrin e shtëpisë. Tashmë gjërat e tjera Nikoja i merrte me mend. I ati vazhdonte ta thërriste ndërsa mprihte sëpatat me limë në hajat. Nikoja kishte shumë dëshirë të flinte e të mos zgjohej kaq herët. Të gërvishurat e limës e shqetësonin shumë, por ai do të duronte çdo zhurmë, veç të flinte edhe ca.

— Niko! Niko! — u dëgjua përsëri zëri i të atit nga hajati.

Djali me shumë përpjekje hapi sytë dhe nisi t'i fërkonte me duar. Sapo kishte zbardhur drita e nëpër të çarat e kanatave të dritareve ca rreze të dobëta krijonin figura të ndryshme në murin e dhomës. Nikon e zuri përsëri gjumi me krahët mbi jorgan. I ati vazhdonte të mprihte sëpatat dhe kujtonte se i biri po vishej. Ai i thirri dja-

lit edhe dy-tri herë dhe, kur ai nuk u përgjigj, hapi derën me rrëmbim e u fut në dhomë me limë në dorë. Ai nuk do ta rrihte të birin (kishte një vit që nuk vinte dorë mbi të), po për ta sharë do ta shante me çdo fjalë që t'i vinte për mbarë. Po kur pa të birin ashtu me krahë të kryqëzuar mbi jorgan, sikur u zbut. Plaku prej natyre ishte i egër dhe s'i bënin përshtypje gjëra të tilla. Po kësaj radhe dhe ai u çudit me butësinë e vet. Për herë të parë pas kaq vitesh, ndjeu dhembshuri për të birin dhe mendoi se po e mundonte ca si tepër. Shpesh i kishte thënë të birit: «U bëre burrë» dhe, në fakt, e vinte të bënte punë burrash. Plaku njëherë mendoi ta linte të birin që të flinte edhe pak, por, po ta bënte këtë, ishte e kotë të shkonte në pyll. Rënia e diellit druvarin duhet ta gjejë në pyll, mendoi plaku. Ai kishte mbi tridhjetë vjet që shkonte në pyll shumë herët, që pa rënë dielli. Vendosi ta zgjonte të birin.

— Niko! Niko! — i thirri me zë të ulët e disi të butë. Po i biri nuk dëgjonte e vazhdonte të flinte. Atëherë plaku iu afrua te shtroja dhe ra në gjunjë para djalit. Për disa çaste e vërejti se si flinte i biri, se si i ngrihej dhe i ulej gjoksi i vogël. Ai vështroi duart e tij dhe iu dukën tamam duar fëmije. Gishtërinjtë e të birit iu dukën të gjatë dhe vende vende i kishin formuar kallo.

— I ati e kapi të birin nga supet dhe e shkundi lehtë.

— Niko! Zgjohu, se u bë vonë, — i tha me dhembshuri.

Kësaj radhe djali u zgjua dhe menjëherë u ngrit në këmbë.

Ashtu, vetëm me kanatjere e të mbathura të shkurtra, ai dukej edhe më fëmijë. Të katërmbëdhjetë vjetët e djalit tani plakut iu dukën sikur kishin ikur shpejt dhe nuk e kishin bërë si duhej punën e tyre. Plaku vështroi këmbët e djalit që ishin të gjata, po fare të holla e pak të shtrembra. Gjunjët i afroreshin njëri-tjetrit përbrenda si-

kur donin të takoheshin. Djali edhe krahët i kishte kësh-tu: të gjatë e të dobët. «I ka ecur trupi si lastar, se akoma është fëmijë. Sëpata në duart e tij është e rëndë», mendoi plaku. Po për një njeri si ai ndjenja e dhembshurisë ishte dobësi e çastit dhe ai largohej prej saj sa më shpejt që të ishte e mundur, bile si me neveri. Ai ishte rritur jetim. Askush nuk kishte treguar dhembshuri për të gjatë tërë jetës, dhe ja tani ai e kishte të vështirë ta quante dhembshurinë një ndjenjë të mirë, ndaj dhe përpiqej ta largonte. Mbi të gjitha ndjenjat te plaku sundonte ajo e detyrës, sado që për të ai kishte një kuptim të vetin.

Djali nxitonte të vishej. Ai përpiqej që të mos e zemëronte të atin, edhe kur ai nuk kishte të drejtë. Disi në mënyrë të trubullt djali e shihte se i ati në shumë gjëra nuk kishte të drejtë dhe nuk vepronte mirë. Dhe ai sipas mënyrës së tij ia thoshte plakut, por nuk shfaqte as kundërshtimin më të vogël ndaj urdhrave që i jepte i ati.

— Hidhu një dorë ujë syve, se po na rrezohesh udhës,
— i foli i ati.

Këto fjalë tingëlluan si qortim dhe nuk i erdhi mirë as të atit që i tha dhe as djalit që i dëgjoi.

— Mos jam rrëzuar ndonjëherë? — tha i prekur në sedër djali.

— Jo, po thashë. Ne, zaten, kaluar ecim kur shkojmë... Po uji i ftohtë t'i hap sytë e t'i bën filxhan.

Djali mori katruven me ujë, doli në oborr dhe u hodhi ca grushte syve. I fshiu sytë me mëngën e xhaketës prej doku dhe duart i futi në xhepa që të mos i mërddhinin.

Plaku po merrej me pregatitjen e mushkës e të gomarit. Ai u vuri kafshëve samarët dhe u kontrollonte litarët nëse i kishin në rregull apo jo.

— E ke në rregull gomarin? — e pyeti plaku të birin.

Djali vështroi gomarin dhe pa e vrarë shumë, ndonëse e merrte me mend se diçka mungonte te kafsha, sepse

i ati vazhdimisht ia bënte këtë lodër, gati si me buzë në gaz, u përgjigj:

— Në rregull!

— Në rregull, ë? Po ky ç'është? Rregull i thua ti këtij, — tha plaku i nxehur kësaj here dhe tundi një copë litar mbi samarin e gomarit. — Nuk ke ndërmend të mësohesh për të punuar me kafshën ti, jo. Ja, këputet litari e ti nuk e shikon, vret samari kafshën e ti nuk e shikon, ti... kafsha nuk i sjell drutë nga mali, por i sjell njeriu. Ja, kështu është.

Djali u afrua pranë gomarit dhe vuri re se litari i samarit që duhej për të ngarkuar drutë ishte këputur. Plaku rrinte duke shikuar se ç'do të bënte djali. Nikoja kërkoi fillin tjetër të litarit, e kapi dhe nisi t'i lidhte.

— Jo, jo kështu. Tani litari bëhet i shkurtër, prandaj duhet shtuar. Shko e merr një copë litar tjetër brenda.

Pas pak Nikoja u kthye me nja dy pash litar në duar.

— Lidhe tani, — i tha plaku.

Plaku mund ta lidhte fare bukur vetë, më shpejt se i biri, por Nikoja e kuptoi se ai ia la këtë punë për të parë se si do ta lidhte litarin. Se edhe lidhja ka mjeshtërinë e vet. Djali i bëri bashkë dy fijet e litarit dhe i lidhi me një nyje të fortë, duke lënë ca litar në fund. Plaku mori frymë i kënaqur. Atij i pëlqenin punët e sigurta.

— Tani shko në mashen dhe merr një krah jonxhë, — i tha ai të birit.

Si rregulloi jonxhën në samarin e mushkës, ata u nisën, plaku hipur mbi mushkë e Nikoja mbi gomar.

Mëngjesi i vjeshtës ishte i freskët dhe Nikoja ndjeu të ftohtë. Ende dielli s'kishte lindur. Yjet nuk ishin zhdukur nga kupa e qiellit, por tani ato nuk ndriçonin. Nikoja mendoi se yjeve, ngaqë kishin ndriçuar tërë natën, u vinte gjumë dhe ishin të lodhura. Ato vërtet ishin të zbeta dhe lëshonin një dritë të bardhë, të dobët në sfondin e përhim-

të të qiellit. Djalin e joshte misteri i universit e ai nuk ngopej së pari qiellin e yjet. Pastaj i hodhi sytë lumit, i cili dredhonte midis dy shpateve të maleve. Ai ngjante me një shirit të bardhë, të gjatë, që nuk i dukej as fillimi as fundi. Djalit i pëlqente shumë si qielli, ashtu edhe lumi, po më shumë i pëlqente pylli. Pylli atë e joshte me shushurimën e ëmbël të fletëve, me erën e mirë që vinte nga rrëshira dhe nga gjethet e thata. Ai e kishte qejf pyllin, sidomos kur gjethet e tij fillonin të zverdheshin dhe në të rënë të diellit dukeshin si të lara në flori. Përveç dëshirës së t'et, mbase ishte kjo, dashuria për pyllin që e bënte atë të ngrihej aq herët çdo ditë e të merrte një rrugë aq të gjatë. Por, po ta vështroje thellë-thellë do ta mendoje se Nikoja kishte një shpirt poetik, një natyrë të pasur dhe të ndjeshme.

— E ke sëpatën? — ia preu mendimet i ati.

— E kam, — tha djali.

Plaku kishte kohë që priste dru dhe i shiste në qytet. Qyteti ishte dy orë larg, po ata shkonin çdo ditë. Në fillim drutë i shiste vetëm plaku, ai vinte para mushkën dhe gomarin dhe i shpinte drutë vetë. Po kishte disa muaj që ai merrte me vete edhe Nikon. Djalit puna në pyll i vinte si i vinte, lodhej e djersitej duke bërë dru e duke i ngarkuar, po të paktën thithte ajër të pastër e kënaqej me natyrën. Ama shitjen e druve në qytet ai e kishte tepër bezdi, madje i vinte dhe turp. Do të bënte me qejf edhe punën më të rëndë, veç të mos shiste dru në qytet. Djalit që në fillim nuk i pëlqeu kjo punë.

— Më vjen turp, baba, — i tha një ditë, — nuk dua të vij më në qytet, dua të vazhdoj shkollën.

— Turp të kesh për gjëra të tjera dhe jo për të fituar bukën e gojës, — i qe përgjigjur i ati tërë nerva. — Ndërsa në shkollë s'ke për të vajtur. Mjaft i ke shtatë klasë. — Nikoja e kuptoi se i ati e kishte vendosur njëherë

e mirë e s'do të hiqte kollaj dorë nga ai vendim, ndaj atë ditë u hidhërua shumë.

... Nikoja shikonte të atin me kurrizin e përkulur mbi mushkë. Ai i ra gomarit me këmbë në bark dhe kafsha nxitoi. Nikoja deshi t'i afrohej t'atit. Një si lëmsh i qe mbledhur në grykë dhe nuk mund të rrinte pa e shfryrë.

— Baba, e kuptoj se kush e ka fajin që unë nuk po vete në shkollë, — tha ai sikur ata të kishin biseduar tri minuta më parë për këtë problem dhe jo tre muaj më parë.

Plaku u nxeh, siç ndodhte sa herë që i biri e zinte ngushtë.

— Kush e paska fajin? Unë? — pyeti ai i zemëruar.

— Ne mbetëm të veçuar nga fshati, baba. Sikur të futeshim dhe ne në kooperativë së bashku me të tjerët, nuk do të kishim nevojë të shitnim dru.

— Nuk i shesim drutë se jemi pa bukë, — i tha i ati.

— Po përse e bëjmë këtë?

— Na duhen para. Ca para mënjanë duhen, biro. Po kaloj paraja nga njëra dorë te tjetra, ke marrë fund. Ne nuk do të shesim dru gjithmonë. Tani kjo punë bie para, nesër ndonjë punë tjetër. Tani ne vrapojmë pas kësaj, nesër pas asaj tjetrës. Dhe paraja shtohet. E vë mënjanë atë dhe e flë mendjen. Kështu është, biro.

Plaku fliste me pasion. Nikoja u habit që plaku u gjallërua aq shumë. Secili ka një vatër detyrash nga ku ndizet pasioni dhe kjo vatër për plakun ishte paraja. Po ndryshe e shikonte paranë plaku. Atë ai nuk mund ta shikonte si një i pasur. Ai nuk e kuptonte si duhej kohën në të cilën jetonte dhe kishte frikë se mos ndodhej në buzë të greminës së llahtarshme. Paraja do ta mbante atë që të mos rrokullisej. Djali nuk e kuptonte se ç'ishte ai pasion i plakut për të grumbulluar para....

Pas pak ai nuk mendoi më për ato që i tha plaku. Atë

e rrëmbeu prapë bukuria e pyllit. Natën kishte rënë pak shi, por aty afër mëngjesit moti qe kthjelluar. Pikat e shiut kishin mbetur në gjethet e verdha të drurëve. Sa herë binte rruga pranë drurëve, Nikoja i tundte ata dhe pikat e shiut i binin mbi kokë e mbi supe. Gomari tundte veshët i shqetësuar, kurse Nikoja kënaqej nga ai dush i lehtë shiu. Djalit i dukej sikur edhe pikëzat e shiut ishin të verdha, ashtu si gjethet, i dukej sikur edhe ato kishin erën e mirë të gjetheve të thata. Ai i shikonte me ëndje drurët e drejtë të ahut dhe nuk donte t'u vinte sëpatën. Ata ishin akoma filiza dhe, po t'i lije të rriteshin, pas disa vjetësh aty do të bëhej një pyll i madh.

Kur arritën te vendi i rrafshhtë, Nikoja zbriti nga gomari. Tani atij nuk i bënte zemra ta kapte sëpatën. U mbështet pas një ahu të ri, trupi i të cilit u hepua dhe nga kurora e tij ranë pikat e shiut si pika vese. Nikoja vuri re me keqardhje se ata të dy, atë e bir, e kishin sakatuar e shëmtuar pyllin. Nga nxitimi drurët i kishin prerë jo rrafsh me tokën, por më lart, dhe Nikos i ngjallnin diçka të frikshme, të keqe.

— Niko, hajde, këtu! — i tha i ati.

Djali nuk e dëgjoji zërin e t'et. Në ato çastë ai tundi një dru të hollë dushku dhe i priti në fytyrë pikat e shiut që ranë nga gjethet. Ra dielli dhe pylli sikur u përflak. Tani gjethet e pyllit dukeshin vërtet si të florinjta.

— Niko! Niko! — i thirri prapë i ati.

Djali ktheu kokën po nuk foli.

— More i humbur! Përse nuk flet? Ti je hutuar fare. Hajde të hash mëngjes, — i thirri me inat i ati.

— Nuk më hahet, baba, — tha Nikoja.

— Hajde, mo, se nuk priten drurët pa ngrënë.

Djali u afrua qejfprishur. Plaku hapi mbi tokë një shami të kuqe e nxorri prej saj nga një kavanoz domate

e specia turshi dhe filloi të hante i pari. Filloi të hante edhe Nikoja.

— Baba, nuk është gjynah t'i presësh këta drurë pa u rritur mirë, — tha ai.

Plaku vështroi me habi të birin. Pastaj atij i vajtën sytë te një dru disa hapa më tej. Druri ishte prerë rreth një metër mbi tokë dhe dukej shumë shëmtuar. Trungu i mbetur dukej sikur kishte lidhur kokën me një fasho të palarë. E gjithë kjo e ngrysi edhe plakun, po s'e bëri veten.

— Pylli është yni dhe bëjmë ç'të duam me të. Na duhen drurë, e presim. Paraja nuk fitohet lehtë.

— Pa do të thonë njerëzit, kur do të hyjmë edhe në kooperativë: «Ja, Thanasi e sakatoi pyllin dhe tani firmosi lutjen...»

Plaku kësaj radhe dorën e nderur mbi bukë e ngriti, po shpejt e vuri mbi gjunjë. U bë gati të godiste të birin, por befas iu kujtua se kishte më se një vit që nuk vinte dorë mbi të. Sytë i vajtën te duart e tij të ashpra e të rënda, të vrara nga puna. Kapi përsëri copën e bukës.

— Kjo është toka ime. E di unë në ia jap kooperativës apo jo. Ha bukë tani, në të hahet, dhe mos më jep mend. Dëgjove, spurdhjak! Hajde, baba, të të tregoj arat, i thonë kësaj.

— Po nuk do të rrimë gjithnjë të veçuar, baba. Mua shokët më thonë. «Ja, i biri i Thanasit, i atij që jeton i veçuar nga fshati». Ata as në lojëra nuk më pranojnë.

Plakut nuk i erdhi aspak mirë nga këto fjalë, po përsëri nuk e bëri veten dhe foli me mospërfillje:

— Këtë hall ke ti, se nuk të qasin në lojë ata, ë? Hajde mendje, hajde. Po ti je burrë tani dhe nuk të ka hije të luash me fëmijët, — i tha i ati.

Nikvoja nuk foli. Ai e la bukën.

— Ha, — i tha i ati.

— Nuk më shkon më... U ngopa.

— Mirë, mirë, si të duash. Merr jonxhën e hidhua hajvanëve, — i tha plaku.

Nikoja ua hodhi mushkës e gomarit jonxhën e butë. Kafshët filluan të përtypeshin me kënaqësi. Gomarin e kishte vrarë pak samari dhe djalit i erdhi keq. Ai vendosi që, sapo të kthehej nga qyteti, t'ia mbushte me kashtë të butë samarin gomarit. Filluan nga puna.

Pas dy orësh filluan t'i ngarkonin kafshët.

— U lodhe? — e pyeti i ati kur u vunë në rrugë sa për të hapur muhabet.

— U lodha, — tha djali.

— Paraja është e zorshme në të fituar.

Nikos i vinte shumë inat kur i ati i fliste për para. Ai fliste për të si për diçka të gjallë. Djali kishte vënë re dëshirën e plakut për të grumbulluar para. Kur ishte në klasë të shtatë, iu lut t'et që të blinte një tavolinë dhe nja dy karrige. «Ulu, more aty e shkruaj, — i qe përgjigjur i ati, duke i treguar lëkurën e dhisë. — Na dashke tavolinë ti. Alamet sheh Mazllëmi s'ka as tavolinë, as karrige. e i shkruan nuskat në gjunjë, kurse ti...»

Nikos iu kujtuan të gjitha këto dhe ndjeu ftohtësi për të atin. Që kur kishte filluar të priste dru, atij i dukej sikur kishte rënë në një grackë nga e cila nuk do të dilte kollaj. Bënte një punë, e cila jo vetëm nuk i pëlqente, por ishte disi edhe e turpshme. Atij i vinte të pëlqiste kur hynte në qytet dhe i ati i thoshte: «Ti mbaj andej, unë këndej. Takohemi te xhamia. Dyqind lekë mbaji drutë, asnjë lek më pak. Dhe bërtit: Hajde dru, dru të mira! Ja kështu!» Djali ndahej i pikëlluar nga plaku dhe, duke tërhequr gomarin për kapistalli, shkonte rrëzë apartamenteve. Ai nuk bërtiste, siç e kishte porositur i ati, po priste ta shikonte ndokush që kishte nevojë për dru. Plaku i shiste gjithnjë më shpejt drutë dhe grindej me djaloshin

që ishte i ngathët. Pastaj ia merrte djalit lekët, i fuste në xhep dhe niseshin për në fshat...

— E, mor, ç'mendolesh, — i tha papritur i ati. — Do të biesh në lumë, — i tha ai pastaj.

Rruga kalonte buzë lumit, në një tërthore. Vërtet ishte një vend i rrezikshëm, ku duhej të kishe kujdes.

— Baba, — i tha Nikoja, — unë dua të punoj në kooperativë. Ditën do të punoj, natën do të mësoj. Kanë hapur një shkollë për agronom.

Plaku u ngrys në fytyrë. Ai deshi t'ia priste shkurt, siç bënte shpesh, por u mendua:

— Sa do të paguhesh? — e pyeti ai të birin.

— Është me normë, — tha djali.

— Mirë, mirë, po sa vete sikur të punosh kështu...?

— Pesëqind lekë në muaj dhe shkollën, — tha djali.

— Ta mendojmë, — tha ai.

Ata mbërritën te kryqëzimi i rrugëve: njëra rrugë të shpinte në fshat, kurse tjetra në qytet. Nikoja deshi ta kthente mushkën nga rruga për në qytet, por i ati i tha:

— Lëri, lëri!

— Përse?

— Do t'i grumbullojmë në shtëpi drutë. Do t'i shesim në janar e në shkurt, se atëherë thahen e shiten më me hesap, — tha plaku.

Djaloshit i shkëlqyen sytë.

«Gjer atëherë unë do të kem vajtur në shkollë», — mendoi i lumtur sa s'kishte më...

NJERIU QË ÇALONTE NË ASFALT

Aty ishte një kryqëzim rrugësh dhe pasagjerë të shumtë prisnin që të niseshin në drejtime të ndryshme. Unë prisja ndonjë Shytë nga ato që shkonin për t'u ngarkuar në minierë. Destinacioni i tyre dihej, dhe vetëm kur shihja ndonjë të tillë, ngrihesha dhe i nxirrja dorën. Shofërët i hidhnin një sy agjencisë dhe, kur shihnin që sporteli ishte mbyllur, na shikonin me keqardhje dhe vazhdonin. Nganjëherë lëshonin për një çast timonin dhe kryqëzonin duart para kraharorit për të thënë «e kam plot». Si për të vërtetuar fjalët e shoferëve, prapa xhamave të kabinave na vështronin me indiferencë ose me keqardhje të lehtë pasagjerët që kishin zënë vend në kolltukët e butë. Shumë nga ne kishim kohë që prisnim dhe dihet që pritja e gjatë të mërzit. Në atë kryqëzim rrugësh vinin fëmijë për të shitur fiq. Ata i shitnin fiqtë me kokrra, e megjithëkëtë njerëzit blinin. Mbase këtë e bënin më shumë ngaqë s'kishin ç'të bënin. Vetëm një plak nuk jepte shenja mërzie. Ai ishte fshatar i asaj ane. Ishte ulur këmbëkryq në sheshin e bleruar dhe pinte duhan i qetë. Pranë plakut ishin ulur dy gra dhe një vajzë me veshje qytetare.

— Më duket se ka për të ardhur treni deri këtu, — foli gruaja që ishte e moshuar. Po ta gjykoje nga veshja e nga të folurit, dilte se edhe ajo ishte fshatare e atyre anëve. Plaku i hodhi një sy gruas dhe tha:

— Mirë, o, mirë. Edhe mund të vijë, po sot nuk vjen,
— tha plaku.

— Për ku do të udhëtoni, xhaxho? — e pyeta unë.

— Për në minierë. Kam djalin me gjithë familje atje. Jam bërë me nipçe dhe po shkoj t'i vë emrin, — tha ai i kënaqur.

— Se mos e kanë lënë pa emër, — tha gruaja që pak më parë foli për trenin.

— Nuk i vënë emër pa vajtur unë, — tha plaku.

— Çfarë emri do t'i vësh, xhaxho? — e pyeti vajza që qëndronte pranë grave në këmbë.

— Çfarë emri, the? Emrin e gjyshit. Osman e quanin gjyshin, — tha plaku duke përdredhur mustaqet. Vajza u shkri në gas. Në këto çaste vjen një Shytë që i kishte vendet të pazëna. Ne ishim tre vetë që do të udhëtonim për në minierë, unë plaku dhe vajza. Vajza u ul në vendin e parë, plaku në kolltukun pas vajzës dhe unë në atë pas shoferit. Unë prisja që plaku të na fliste akoma diçka rreth nipçes që i kishte lindur dhe për emrin që do t'i vinte. Mbase plaku do të fliste vërtet, po shoferi hyri në bisedë me vajzën pa na përfillur fare as mua dhe as plakun. Shoferi fliste, fliste e qeshte me vajzën duke e shtuar shpejtësinë e makinës. Ai vështronte vazhdimisht nga ajo dhe timonin e rrotullonte me indiferentizëm, sikur të ishte një lodër në duart e fëmijëve. Kjo, sigurisht, nuk kishte lidhje me mjeshtërinë dhe manovrimin e mirë në timon, po me mungesën e plotë të vëmendjes dhe të kujdesit. Po bëhesha gati t'i thosha shoferit që, po të donte të bënte muhabet me vajzën, ta ngadalësonte shpejtësinë e makinës. Edhe plaku, dukej një gjë të tillë mendonte. Vajza e kuptoi shqetësimin tonë e përpiquej që të fliste sa më pak që të ishte e mundur me shoferin. Më vonë ajo filloi t'u përgjigjej vetëm pyetjeve të tij dhe më në fund heshti, duke i ngulur sytë mbi xhadenë e asfaltuar

që gjarpëronte në shpatin e malit. Nuk vonoi dhe vajza zbriti. Ajo ishte arsimitare në një fshat aty pranë. I hodha një shikim të shpejtë plakut dhe vura re fytyrën e vrenjtur të tij. Dukej ai ruante për vajzën përshtypje jo të mira, kurse mua më erdhi keq që pak më parë e kisha marrë inat vajzën. Fundja ajo nuk kishte asnjë faj. Kolltuku ku qe ulur ajo mbeti bosh.

Shoferi nuk hyri në bisedë as me mua dhe as me plakun, dhe e ngiste makinën si të mos kishte njeri në të. Mua dhe plakut na zinte shpesh koka në sustën e krevatit që ishte vendosur në kabinë. Plaku deshi të ulej në kolltukun ku pak më parë rrinte vajza.

— Rri atje, po nuk deshe... — nuk e mbaroi fjalën shoferi, i cili për herë të parë e ktheu kokën pas. Mua më erdhi shumë rëndë që ai i foli plakut në atë mënyrë.

— Mos u mërzit, — i thashë me sy plakut, dhe ia përmenda prapë atë punën e emrit për nipçen për ta sjellë sadopak në humor.

— Kopuku... Do që aty të vijë një tjetër si ajo që pati pak më parë, — m'u duk se thanë sytë e inatosur të plakut.

Pas pak shoferi frenoi dhe në kabinë u fut një burrë rreth të dyzetave. Ai zuri vend në kolltukun ku pak më parë ishte ulur arsimtarja. Unë e plaku u gëzuan se mbase burri i sapoardhur do ta ngrohte bisedën. Ai dukej njeri i mirë. Na pyeti të gjithë për shëndetin dhe na zgjati nga një cigare. Shoferi e plaku i morën, kurse unë jo. Pastaj burri që sapo hyri në kabinë filloi të fliste rreth mbjelljes së patates së hershme, sepse qe koha e saj. Unë mendova se ai duhej të ishte agronom. Pas pak ai filloi të fliste për minierat, për një oficinë mekanike rajonale të sapongritur dhe për një fabrikë të re për pasurimin e kromit. Po dalngadalë ai u bë i heshtur dhe i zymtë. Për një kohë të gjatë nuk foli fare dhe, kur foli, tha ca fjalë

të ashpra e të rënda që më kumbojnë akoma në vesh.

Shoferi e kishte karrocerinë e makinës bosh dhe filloi ta mbushte me pasagjerë. Pasagjerëve që zbrisnin u merrte lekë dhe i zëvendësonte me të tjerë. Në kabinë kishte një bllok me bileta por ai nuk i jepte biletë askujt. Kjo sjellje e shoferit, siç duket, e bëri të heshtur burrin që rrinte në kolltukun e parë. Edhe mua përshtypja për shoferin m'u bë më e keqe kur përballë nesh po vinte një Shytë tjetër ngarkuar me mineral. Shoferi ynë e ngadalësoi shpejtësinë dhe ia bëri me shenjë atij tjetrit që të ndalej.

— Si je, Ndoc, mirë?

— Mirë, — u përgjigj ai që quhej Ndoc.

— A ka njeri përpara?

— Te kthesa është Ivani, — tha Ndoci dhe u nis.

Shoferi e ngadalësoi shpejtësinë. E ndaloi makinën dhe preu tri bileta e i la në kabinë, atje ku mbante fletët e udhëtimit. Biletat ishin dylekëshe kurse ne kishim udhëtuar mbi 60 kilometra. Preu disa bileta edhe për pasagjerët që ishin në karroceri.

— Mbaji, — i tha ai një djaloshi të ri që ishte në karroceri. — Po doli Ivani, ua shpërndaj njerëzve. Kur të zbresësh, m'i jep.

Tashmë shoferi ecte i përqëndruar. Shoferëve që kalonin në drejtim të kundërt me ne, u bënte të njëjtën pyetje: «A ka njeri përpara?» Dikush nuk i përgjigjej fare, dikush i thoshte se te kthesa ishte Ivani. Burrit që rrinte pranë shoferit filloi t'i dridhej një nerv mbi ballë. Ai nxori paqetën ta ndizte dhe harxhoi dhjetë fije shkrepëse për një cigare. Pastaj ai i nguli sytë asfaltit të xhadesë... Edhe ai dikur kishte qenë shofer dhe ajo që e kishte ndarë nga timoni kishte ndodhur një vit më parë. Ai punonte në veprën e madhe të dritës. Kishte njëzet orë që rrinte pa pushuar mbi timon. U fut në fjetore që të merrte «një sy gjumë», siç thoshte Xha Llambi. Derën e

hapi ngadalë dhe hoqi këpucët që të mos bënte zhurmë. Shokët flinin. Ai u çudit kur pa sobën që ishte ndezur. Pranë saj qe ulur dhe pinte duhan xha Llambi. Ai, sapo pa shoferin, lëvizi paksa që t'i lironte vend në stolin pranë sobës.

«Hajde, Pandi, hajde ngrohu», — ia bëri me shenjë xha Llambi.

Pandi iu afrua plakut ngadalë dhe e përqafoi, siç bënte shpesh, kur kthehej nga rrugë të largëta.

— Si je, more xha Llambi? Gjallë qenke?

— Gjallë, biro! Po ndize njëherë. Është «Sheldije», — tha ai duke i zgjatur kutinë e duhanit.

— Më djegin sytë për gjumë, xha Llambi, — tha shoferi.

— Ndize, more njëherë, pa për të fjetur kemi, — tha plaku dhe shoferi nuk ia prishi. Ata pinin duhan dhe bisedonin me zë të ulët që të mos zgjonin shokët. Pastaj ai u shtri të flinte, kurse xha Llambi mbeti te soba. Nuk kaloi gjysmë ore dhe në kantier u dha alarmi. U ngrit menjëherë xha Llambi dhe i zgjoi shoferët që flinin.

— Mos bërtit, more lanet, — i tha Zikut.

— Përse të mos bërtas, xha Llambi? Edhe thua «alarm», edhe... s'arriti të mbaronte ai.

— Nuk dua të zgjohet Pandi, more bir. Ai tani sapo ra të marrë një sy gjumë. Ka udhëtuar njëzet orë pa fjetur, — tha ai me keqardhje.

— Më fal, xha Llambi, nuk thërras më, — tha Ziku si i zënë në faj.

Po qe e pamundur të flije. Pandi u zgjua.

— Rri ti, Pandi. Ti je pa gjumë, — iu lutën shokët e xha Llambi.

— Edhe ju pa gjumë jeni, — u tha ai shokëve dhe u vesh shpejt.

Dolën përjashta. Litarët e hekurt të shiut kërcisnin

mbi barakat e mbuluara me letër katramaje. Lumi kishte dalë nga shtrati krejt papritur dhe po vërshonte drejt sektorit të makinerive. Duheshin shpëtuar makineritë dhe kjo, në radhë të parë, ishte detyrë e shoferëve. Ata vrapuan e ndezën motorat. Edhe Pandi ndezi «harushën» e tij dhe u nis bashkë me shokët. Punuan deri në mëngjes dhe makineritë i shpëtuan. Pandi po bënte rrugën e fundit, kur... xhadeja i shkau nën rrotat e makinës dhe... Makina nuk pësoi gjë, se dheu që i butë, po Pandi ishte mbuluar në gjak. Shokët morën batanijen që mbante Pandi në sedile dhe e çuan urgjent në spital. Kur Pandi erdhi në vete, të gjithë shokët i pa rreth e rrotull. Ishte dhe xha Llambi.

— Shpëtove bir, shpëtove, — tha plaku dhe një lot iu var në cepin e syrit.

Pandi u përpoq të rrotullohej, por nuk mundi të bënte asnjë lëvizje. I dukej se në njërin këmbë i rëndonte mali i Dejës. Pastaj i hodhi një sy krahut dhe e kuptoi se ai nuk bënte më për timon...

Atij ia prenë kujtimet të trokiturat sipër kabinës. Dikush deshi të zbriste dhe shoferi frenoi. Zbriti një i ri.

— Sa bën rruga? — e pyeti ai shoferin.

— Dhjetë lekë, — u përgjigj shkurt e nervoz ai.

— Më jep biletën, — tha djaloshi duke nxjerrë nga xhepi një dhjetëlekëshe.

— Tund, ore, paret! Dashke biletë ti! — iu hakërrye shoferi.

— Biletën, ose nuk merr para nga unë, — tha shkurt djaloshi.

— Me shërbim je ti? — pyeti kësaj here shoferi më i qetë.

— Kjo nuk ka rëndësi, — tha djaloshi me zë të lartë.

— Mirë, mirë! E kam fajin unë...

Ai shkeli freksionin dhe makina u nis. Tashmë hesh-

tja në kabinë u bë edhe më e thellë. Pothuaj dëgjonim frymëmarrjen e njëri-tjetrit. Burri që rrinte në krah të shoferit shuante e ndizte vazhdimisht cigaret. Edhe plaku tymoste llullën e tij.

— Do t'i bëhet qejfi djalit kur të të shohë, — i thashë unë plakat sa për t'u ndodhur në bisedë.

Nuk e kuptova a nuk dëgjoj plaku apo nuk deshi të më përgjigjej. Më shumë ka të ngjarë që ai të mos ketë dashur të më përgjigjej. Ishte bërë shumë nervoz. Një Shytë me mineral po vinte përballë nesh. Shoferi ngadalësoi pak shpejtësinë dhe bëri atë pyetjen e zakonshme: «A ka njeri përpara». Nuk e dëgjuam si u përgjigj shoferi tjetër, se nuk na la zëri bubullimë i burrit që ishte ulur në vendin e vajzës.

— Me siguri që ka njerëz përpara! Posi, ka!

Ne u habitëm. Shoferi e ngadalësoi në maksimum shpejtësinë dhe pyeti burrin që kishte në krah:

— Ç'pate, si të erdhi?

— Ndal makinën! Ja, çfarë kam! Më mirë eci më këmbë sesa të udhëtoj me ty.

— Udha e mbarë të qoftë, — tha shoferi duke frenuar. Po burri nuk u hodh nga kabina.

— Ti na fyen ne, shoferët. Na nxjerr namin e keq. Ne nuk jemi si ti.

— Nuk kam nevojë për moral, — tha shoferi. — Po deshe, zbrit.

— Ti ke shumë nevojë për moral, — i thashë unë shoferit.

— Ore, ti nuk qenke burrë, — iu hodh plaku atij. Plakut i dridheshin pendët e mustaqeve nga zemërimi.

— Kam punuar njëzet vjet shofer, — tha përsëri burri që rrinte në krah të shoferit, — por nuk kam bërë kurrrë poshtërsi të tilla. As shokët e mi nuk bëjnë kështu, as të tutë jo. Janë të rrallë ata që veprojnë si ti, dhe, me-

gjithëse nuk punoj më në timon, më vjen keq, më vjen turp për këtë që bën ti.

Pastaj ai hapi me rrëmbim derën dhe u hodh në xhade. Ne vetëm tani e dalluam se ai nuk e kishte njërin krah dhe nga këmba e majtë çalonte. Pasi bëri dy hapa e kuptuam se edhe këmbën nuk e kishte të vetën. Nga balli i rridhnin djersë të ftohta.

Shoferi u përkul mbi timon. Ai nuk kishte më guxim ta ngrinte kokën, por dhe makinën s'e ndezi, zbriti e u drejtua për nga burri që çalonte mbi asfalt.

ME SHËRBIM

Kisha kaluar shpesh përmes atij qyteti të vogël, por kurrë nuk më kishte shkuar në mendje se mund të qëndroja disa ditë atje. Po ja, tani isha me shërbim. Qyteti nuk më kishte pëlqyer as më parë, por tani që binte shi dhe hotelxhiu mungonte në sportel, ai m'u duk edhe më i mërzitshëm. Ngrita jakën e pardesysë dhe fillova të ecja nëpër rrugën kryesore. Shiu pushoi papritur dhe, aty për aty, dielli sikur i largoi me një dorë të padukshme retë e lëshoi rrezet e tij mbi tokë. Po dhe vrojtuesi më i keq i motit e kuptonte se dielli nuk do të ndriçonte për shumë kohë atë ditë. Dhe vërtet, pa kaluar as dhjetë minuta, koha u prish. Retë mbuluan qiellin dhe zunë diellin. Pastaj retë u shtuan dhe ndonëse ishte pasdreke, kujtoje se kishte rënë muzgu. Unë u ngrysa ashtu si moti. Papritmas e ndjeva se mërzia ime kishte lidhje jo me qytetin, por me vetminë. Ndihesha më shumë i vetmuar sesa i mërzitur. Shiu ashtu si pushoi papritmas, ia nisi prapë. Këtë radhë binte një shi kokërrmadh. Një nga arsyet e mërzisë sime ishte edhe ajo ditë me shi. Tani s'mund të rrija jashtë. Meqenëse nuk kisha punë, u futa në kafenenë buzë trotuarit. Aty kishte shumë njerëz, zhurmë dhe tym duhani. Për vende as që bëhej fjalë, po aty nuk rrihej as në këmbë. Kalimtarët, të trembur nga ai shi i rrëmbyer, kishin vrapuar për në kafene. Pinin nga një kafe

në këmbë duke fshirë me duar xhamat e kafenesë që visheshin me avull nga afshi i tyre i ngrohtë. Ajri aty ishte i lagësht, i mbushur me avuj. Mezi gjeta një vend dhe u afrova në banak, pranë ekspresit. Isha i kënaqur me vendin që gjeta. Gjithnjë, kur nuk ulem, më pëlqen ta pi kafenë pranë ekspresit. Ekspresi gjithnjë më ngjall një ndjenjë të mirë. Po banakieres sikur nuk i pëlqeu që unë zura vend aty pranë.

— Një kafe, — i thashë asaj.

— Kamerieres thuaji, — ma preu ajo.

Pastaj sikur u pendua që më veçoi, se bënte kafe dhe pa porosinë e kamerieres, ndaj më pyeti:

— Si e doni?

— Ekspres, — i thashë.

Pastaj kërkova me sy kamerieren që të paguaja kafënë. Ajo ishte një vajzë (të paktën kështu e mendova unë) rreth të njëzetave, që lëvizte jo pa mjeshtëri, midis njerëzve të shumtë që kishin mbushur lokalin. Në fytyrën e saj nuk pashë asnjë shenjë lodhjeje e mërzie, sado që mundahej shumë për të kaluar nga tavolina në tavolinë.

— Mbaj një kafe, — i thashë duke i zgjatur lekët.

— Sapo mora turnin dhe nuk kam asnjë lek të vogël, — tha ajo sikur deshi të më kërkonte të falur.

— Po pres pak, po nuk paska fare vende. Shiu... — i thashë unë.

— Në këtë orë kështu mbushet edhe kur nuk bie shi. Pas pak do të ketë vende sa të duash.

Vërtet pas pak, ndonëse shiu s'kishte pushuar, kafeneja u boshatis. Ora vajti tetëmbëdhjetë dhe radioja po jepte lajmet e ndërmjet të tjerave dha dhe një lajm për shërbimin e kulturuar të kamerierëve në këtë qytet të vogël. Banakierja dhe kamerierja iu afruan radios.

— Ishte për ne, — tha kamerierja kur vuri re se edhe unë e dëgjova lajmin.

— Qenki të dalluar, — i thashë.

Ajo vuri buzën në gaz. Desha ta vazhdoja bisedën me të mbasi dhe nuk kisha nga të shkoja, por ajo largohej sapo mbaronte shërbimin. Ajo jo vetëm me mua që isha i huaj sillej disi e ftohtë dhe e druajtur por edhe me të tjerët, vendasit. Meqenëse tani kishte vende të lira plot, u ula në një tavolinë andej nga fundi. Kamerierja tani bisedonte me banakieren. Po shfletoja një fjalor të vogël. S'di sa kohë kaluan, por u ngrita dhe u ngjita lart në hotel. Sportelisti ende nuk kishte ardhur. Te sporteli prisnin dhe dy fshatarë me një grua, edhe ajo fshatare.

— Kemi një orë që po presim, — u ankua njëri nga burrat kur e pa se edhe unë kisha të njëjtin hall si ata.

— Qenkeni lagur, — u thashë fshatarëve.

— Po. Po nuk kemi as ku të thahemi, — tha gruaja e re.

— Shkoni në kafene, — u thashë.

Ata u ulën poshtë në kafene. Ndërsa unë ndeza një cigare dhe po prisja para sportelit. Vajti dhe gjysmë ore po sportelisti ende nuk po vinte. Atëherë zbrita edhe unë poshtë në kafene. Fshatarët ishin ulur në tavolinën pranë banakut. U ula edhe unë por në fund të lokalit.

— Dëshët gjë? — më tha kamerierja.

— Edhe një kafe, — i thashë unë.

— Ekspres apo turke?

— Ekspres, — i thashë.

Ajo më solli kafënë.

— Si ikën njerëzit kaq shpejt? — e pyeta.

— Qytet i vogël. Më gjashtë e gjysmë të gjithë janë nëpër shtëpi. Më tetë ne e mbyllim lokalin. Të huaj këndej s'para vijnë.

— Nga ky qytet je? — e pyeta.

— Po, — tha shkurt ajo. Desha ta pyesja përsëri për sportelistin por ajo qeshi lehtë dhe u largua. Në ato çaste

vura re se njëri nga fshatarët, ai më i riu, kishte qëndruar disa hapa para tavolinës simë. Ai priste që ta shikojta unë.

— Erdhi sportelisi, Pjetri, — më tha.

— Nga e di? — e pyeta unë.

— E pashë nga dritarja. E njoh Pjetrin.

— Mirë. Faleminderit, — i thashë dhe u bëra gati edhe unë që të ngrihesha. Ndesha shikimin e kamerieres dhe ia bëra me kokë që të vinte.

— Të paguaj, — i thashë kur ajo u afrua.

— Tetëdhjetë qindarka, — tha ajo prerë dhe serioze.

Unë u habita! Mos vallë këtë ajo e bëri nga frika se mos e mbaja me muhabet, apo... dhe sytë ia ngula një plake që, ndonëse bisedonte me banakieren, s'ia ndante sytë kamerieres. Nuk e di pse e lidha qëndrimin e ftohtë të kamerieres me këtë plakë. Kujtova kamerieret e të gjitha lokaleve, por nuk solla ndër mend një kameriere kaq të hutuar e të frikësuar. Përse vallë? Vështrova nga banaku dhe pashë përsëri plakën. Ajo duhej të kishte lidhje me kamerieren. U ngrita në këmbë dhe, sapo hodha hapin e parë, në kafene u fut një shoku im i vjetër, Agim Spathini. Ai, sa më vuri re, erdhi gati me vrap në tavolinën time. U puthëm dhe u përqaftuam. Kishim dhjetë vjet pa u parë me njëri-tjetrin. Me Agimin kisha mbaruar shkollën e mesme. Tani ai drejtonte një seksion në komitetin ekzekutiv të rrethit.

— E, qerrata, e paske ujdisur me Dizin, — qenë fjalët e para të tij.

— Kush është Dizi? — e pyeta unë.

— Ja, kamerierja, e kush do të jetë tjetër, — tha ai duke u gërdheshur.

Mua m'u dukën fyese fjalët e tij. Me Agimin nuk kisha pasur asnjëherë ndonjë miqësi të ngushtë, por, kur takohesh pas shumë vjetësh dhe në qytet të huaj, ndihesh

disi i afërt. Po, tani që ai tha ato fjalë, ftohtësia që kishim në vitet e shkollës sikur u fut përsëri midis nesh.

— Me ç'të drejtë më fyen mua dhe Dizin? — i thashë.

— Sepse ajo është nga ato... si shkruajti Migjeni, hë, se ti i di më mirë se unë këto punë, — dhe më shkeli syrin.

— Ç'ka bërë?

Pyetja ime qe disi nervoze. Unë nuk kisha qejf që Dizi të ishte nga ato dhe të them të drejtën nuk e besoja që ajo, aq e çiltër dhe e qeshur, të ishte e tillë.

— La burrin. Ç'të bëjë tjetër? E kam shok ish-burrin e saj. Është shef llogarie në një ndërmarrje.

Doja ta pyesja se përse Dizi e la burrin, por Agimi nuk më la rast.

— E la kot. Për kapriçio e la. «Nuk jam e lirë me ty», — i thoshte. S'c kuptoj se ç'liri kërkonte. I kishte të gjitha të mirat: televizorin, makinën larëse, frigoriferin, me një fjalë trekëndëshin... U ra me shkelm të gjithave...

— Mbase nuk e bëjnë jetën këto që më numërove ti, — i thashë.

— Përralla! Përralla librash! E cila është jeta? Ja, ore, mirëqenia.

— Dizi nuk paska qenë e lirë, kështu paska thënë, dhe pa lirinë nuk vlen asgjë, — i thashë.

— Liri?! Ç'është kjo liri? Sthurrje, degjenerim, kësaj i thua liri dhe ti?

— Unë nuk u them këtyre liri, — thashë i fyer.

U pendova që i hyra këtij diskutimi me Agimin, jo se nuk kisha argumente për ta bindur, por se ai nuk pranonte asnjë lloj argumenti. Për të ishte e moralshme që t'i thuash gruas «mos, mos!» Dhe arriti kulmi kur tha se burri e ndan gruan vetëm nga halli, kur ajo është e keqe, ndërsa po e ndau gruaja burrin, ajo është dy herë më e keqe. Dhe ja, Dizi kishte ndarë burrin.

— Ngrihemi, — i thashë duke u ngritur i pari.

U ngrit edhe ai. Shiu kishte filluar përsëri. Binte një shi i rrëmbyeshëm, kokërrmadh, që të bënte qull.

— Shkojmë nga shtëpia, — më propozoi Agimi duke më zgjatur edhe çadrën.

— Faleminderit. Kam zënë hotel, — gënjeva dhe më erdhi turp që e bëra një gjë të tillë.

— Nuk ka lezet të flesh në hotel, kur takon një shok. Të paktën sonte...

Ai i tha këto fjalë me sinqeritet por unë nuk mund t'ia plotësoja dëshirën.

— Do të rri disa ditë këtu, ndonjëherë tjetër, — i thashë sa për të shpëtuar.

— E po mirë, kur të duash hajde. Po kam frikë se do të harrosh fare.

— Nuk harroj, jo, — i thashë. — Natën e mirë.

— Natën e mirë.

I dhashë dorën Agimit dhe u ngjita me vrap në hotel. Sportelisti kishte ardhur.

Ishte përkulur mbi një regjistër të madh dhe shënonte. I zgjata edhe unë pasaportën time. Xha Pjetri, kështu quhej ai, shkruante tepër ngadalë dhe me një shkrim gati të palexueshëm.

— Le që kalemit nuk ia them dhe aq por më kanë lënë edhe sytë, — tha plaku.

— Epo mosha, — i thashë si për ta ngushëlluar.

— E ndez? — më pyeti ai duke më zgjatur një qeskë me duhan.

— Faleminderit, — i thashë dhe fillova ta dridhja.

— Është ca i fortë po nuk të jep kollë, — tha Pjetri për duhanin.

— Paskam harruar të marr shkrepëse, — i thashë atij duke i zgjatur paqetën «Ardian».

— Jepi lekët djalit, — më tha ai duke më treguar një çunak rreth dhjetëvjeç që rrinte në sportel.

— Tani kafeneja është mbyllur. Dizi po bën pastri-min dhe nuk e hap derën, — shpjegoi çunaku.

— I thuaj se e dua unë, — e porositi djalin plaku. Djali iku.

— Është grua e mirë Dizi por i ndodhi keq, — tha pas pak plaku. — Takoi me një njeri të keq. Mirë bëri, me të keqin nuk jetohet, — vazhdonte të fliste plaku me gjysmë zëri, thujse i thoshte ato fjalë më shumë për vete se për dëgjuesin. Djali solli shkrepësen dhe ne ndezëm cigaret. Xha Pjetri heshti dhe unë mendova se ai nuk do të fliste më për Dizin. Unë kisha shumë dëshirë të dëgjoja se çfarë do të thoshte plaku për të. Brenda një kohe kaq të shkurtër ky ishte njeriu i dytë që po më fliste për të dhe unë krahasoja mendimet. Plaku fliste mirë për Dizin.

— E përgjonte Dizin ai, e përgjonte, — tha xha Pjetri, — Burri që është burrë nuk e ruan gruan. Kur nuk i beson, më mirë mos rri me të. Ai që ruan gruan nuk është burrë, po zagar.

— Çudi, — thashë unë. — Pak më parë njëri më foli keq për Dizin.

— Të pashë me kë ishe ulur në tavolinë. Unë hyra në kafene po ju ishit futur në të thella e nuk më vutë re. Agimi nuk sillet më mirë me gruan e vet. «Është injorante» thotë, po kush e bëri të ditur Agimin? Partia! Partia ia hapi sytë. Po edhe kjo kokë ka faj...

Pastaj ai goditi me gishtin tregues kokën e tij dhe unë u habita përse ai e quante veten fajtor.

— Ti nuk di gjë përse flas unë kështu, ë?

— Jo!

— Ke të drejtë, more bir! Agimi ka për grua vajzën time. Nuk ia dhashë me zor, po ma kërkoi vetë. «Aman, derman, më thoshte, se e dua Athinanë». «Po ç'do me

Athinanë time ti, i thosha unë, ajo është pa shkollë», po në fakt gjetkë e kisha hallin unë. Ai qerrata e kuptoi dhe m'u vu: ti je fanatik... Ti kështu e ti ashtu, gjersa një ditë pranova. «Po ja, tani ma shan vajzën, ma quan injorante: tani shan edhe Dizin dhe mban anën e atij, shokut të tij... Plaku ndonëse fliste qetë, nuk ishte i qetë për-brenda.

* * *

Të nesërmen në mëngjes e pashë përsëri Dizin. Vende kishte dhe unë u ula në tavolinën ku isha ulur një natë më parë. Dizi erdhi tek unë dhe pasi më përshëndeti, më mori porosinë.

— Bisedova mbrëmë me Pjetrin për ty. Ai m'i tregoi të gjitha, — i thashë asaj.

Ajo u skuq nga turpi. Siç duket nuk i erdhi mirë që një i huaj mori vesh punën e ndarjes.

— Çfarë të tha xha Pjetri, — tha pas pak dhe sytë i morën një shkëlqim të veçantë.

— Më foli shumë mirë për ty, Dizi.

Dizit i erdhi mirë që i thashë ashtu, po nuk e bëri veten.

— Iku e shkoi ajo punë, — tha me hidhërim ajo.

— Më parë të ruante burri, tani të ruan nëna, ti prapë...

— Nëna vetëm kujdeset për mua pas asaj që ndodhi. Vjen e më merr në mbrëmje, ndonëse shtëpinë nuk e kam larg. Ky është një kujdes nëne që durohet, kurse ai... ai ishte i padurueshëm. Më gjurmonte fshehurazi, vinte shokë të më përgjonin. E ndieja vazhdimisht veten të fyer e të poshtëruar.

— Po tani ç'bën ai? — pyeta unë dhe e kuptova në çast se bëra gabim.

— Vjell vrer kundër meje. Po nuk ia var më njeri. Shokët e partisë po e shohin qëndrimin e tij. I shkon pas avazit vetëm Agimi, ai shoku që takove mbrëmë. Po dhe ai si im shoq është.

— Dizi, — i thashë, — ti ke bërë shumë mirë që ke vepruar kështu. E marr me mend sa të vështirë e ke pasur, dhe vazhdon ta kesh edhe sot, po më mirë. Të paktën s'lejove të të marrin nëpër këmbë.

Sytë e Dizit shkëlqenin dhe më dukej se nga çasti në çast një psherëtimë e fortë do të hapte buzët që i mbante shtrënguar.

NJË NATË PA GJUMË

Kisha më se dy orë që prisja në qafë të malit të kalonte ndonjë makinë për të shkuar në minierën B.

Era, që dukej sikur vinte nga tërë anët, të thante. Ajo përplasej me tërbim në peshoren e mineralit dhe të dy ndërtesat e vogla. Isha strukur së bashku me disa udhëtarë të tjerë pas një ndërtese dhe prisja, me veshë të ngritur, mos kapja zhurmën e ndonjë makine. Herë pas here vinin makina dhe dalngadalë udhëtarët që ishin atje në qafë të malit u pakësuan. Një çast mendova se mos vallë ishte e vështirë të shkoja në minierë. Kjo për shkak se rruga malore kishte qenë e shembur këto ditë. Mirëpo dje ishte rregulluar.

«Me siguri shoferët do të jenë lajmëruar». Pra ata do të vinin, po rëndësi kishte të vinin sa më parë, sepse bënte shumë ftohtë. Kur ke të ftohtë nuk të rrihet në një vend, ndaj dhe fillova të bëja shëtitje para ndërtesave të vogla, se po më ngrinin këmbët. Nuk kaloi shumë kohë dhe dera e vogël e njërës nga ndërtesat u hap e që andej doli një plak. Ai ma bëri me dorë t'i afrohesha.

— Hajde ngrohu se ngrive! Tani që mbete vetëm mund të ngrohesh këtu me mua. Të gjithëve s'kisha ç't'ju bëja, se dhoma është e vogël, — tha plaku.

Sa iu afrova derës, në fytyrë më ra afshi i ngrohtë i sobës. U futa brenda. Dhoma vërtet ishte fare e vogël.

— Ftohtë, — thashë unë duke iu afruar sobës.

— Je veshur edhe hollë, — tha plaku. — Për ku kështu?

— Për në minierë, — i thashë dhe hodha sytë nga rruga malore që shihej përmes dritares.

— Aha! Këto dy ditë nuk kanë ardhur makina se që prishur rruga. Po sot do të vijnë. E di që janë lajmëruar. Përse shkon në B? — më pyeti pas pak.

— Jam gazetar. Me shërbim, — i thashë.

— Ju gazetarët ju marrin shoferët.

Sa herë që dëgjoja zhurmë motori dilja nga dhoma e ngrohtë dhe i pyesja shoferët se ku do të shkonin. Kisha më tepër se një orë që rrija me plakun. Ai ishte njeri i muhabetit, ndryshe do të isha mërzitur shumë.

— Mos u dëshpëro, he burrë, se ja, një tash, makinat do të shkojnë edhe në B.

Si për të vërtetuar fjalët e tij, në rrugë u ndie zhurma e një makine. Dolëm jashtë së bashku me plakun. Ai vuri dorën në ballë sikur ta vriste dielli dhe hodhi sytë andej nga vinte zhurma. Pas pak u duk një Shtytë.

— Është Pjetri. Ky shkon në minierë, — tha plaku.

Fjalët e tij më ngrohën. Pjetri frenoi para këmbëve të plakut dhe u hodh nga kabina e u përqaftua me të.

— Si je, xha Ali?

— Mirë, — tha plaku dhe qeshi duke mbajtur në dorën e tij të thatë dorën e madhe e të mbushur të shoferit. Pas pak edhe unë e ndjeva shtrëngimin e asaj dore dhe tok me të një farë sigurie.

— Ky është gazetar, ta marrësh për në B. — i tha xha Aliu shoferit për mua.

— Mirë, mirë, po na bëj nga një kafe, — i tha xha Aliut shoferi. Unë u çudita, se aty pranë nuk kishte ndonjë lokal ku mund të pije kafe, po më vonë mendova se

Pjetri bënte shaka. Ai u fut i pari në dhomën e plakut. Pas tij hymë edhe unë e xha Aliu.

Xha Aliu u përkul për të marrë diçka nën tavolinë. Vetëm tani unë pashë se aty ishte dhe një valixhe e vjetër prej dërrase. Xha Aliu nxori që andej një xhezve, tre filxhanë, si dhe dy kavanoza, një me kafe e një me sheqer.

— Si ore, ka dy orë gazetari këtu e ti s'i ke bërë një kafe dhe më lutesh mua që ta marr, — foli duke qeshur Pjetri.

— Tani që siguruam makinën ka lezet kafja, — tha plaku, si të donte të shfajësohej.

Ai na bëri nga një kafe shumë të mirë dhe unë s'e kuptova se ç'më shijoi më shumë, kafeja, apo barcoletat tërë kripë të Pjetrit. Pas gjysmë ore unë me Pjetrin u ndamë me plakun dhe u nisëm.

— Do të mërdhish, — më tha plaku, kur po ndaheshim.

— Jo, he burrë, nuk pyet burri për këtë erë, — foli Pjetri në vendin tim.

— Ti je arushë, — i tha plaku Pjetrit, — po ky është djalë i ri e nuk është mësuar.

Që Pjetri ishte i fortë si ari, për këtë nuk kishte asnjë dyshim, por ai nuk ishte aspak më i vjetër se unë. Plaku me siguri nuk deshë të përmendte dobësinë time fizike dhe futi në mes moshën. Zura vend në kabinë dhe po vështroja përjashta. Rruga i ngjitej një të përpjete sikur donte të takohej me diellin. Poshtë në luginën e thellë rridhte një përrua me ujë të shkumbëzuar që gjarpëronte midis dy shpateve të maleve që zgjateshin paralel me njëri-tjetrin. Në njërin nga këto shpate ecnim ne. Edhe në shpatin tjetër dredhonte një rrugë makine, pothuaj rreth 20 hapa larg përroit. Ajo rrugë ishte disi më e rrafshhtë dhe mjaft e bukur. Më vonë mësova nga Pjetri se ajo rrugë lidhte sektorët e minierës.

— Ke qenë ndonjëherë në B? — më pyeti Pjetri.

— Jo.

— Do të rrish gjatë?

— Dy ditë.

Pjetri mori me mundim një kthesë dhe tha:

— Këto dy ditë do të punoj në tranzit. Pastaj do të kthehem. Kështu që kthehemi bashkë.

Unë e falënderova dhe, kur po bëhesha gati t'i thosha se ku do të takoheshim, ai më tha:

— B. nuk është qytet. Njerëzit në të shihen dhjetë herë në ditë. Ne kemi për t'u parë në klub, në mensë dhe, sigurisht, edhe në sallën e televizorit.

Unë qesha. Rruga dredhonte gjithnjë përpjetë shpatit të malit. Kisha përshtypjen se kishim udhëtuar më se tri orë, por kjo nuk ishte e vërtetë sepse ora ishte katër dhe ne kishim vetëm një orë që ishim nisur.

Pjetri këndonte me zë të ulët një këngë popullore e cila m'u bë shumë e njohur atë ditë. Ishte i gëzuar dhe manovronte me lehtësi në timon.

Kur hymë në B. qe errur. Sapo zbrita nga kabina e makinës ndjeva erën e ftohtë që vinte nga qafa e malit. Një pjesë e punëtorëve shkonin në mensë për të ngrënë darkë.

— Shkojmë edhe ne, — më tha Pjetri duke më treguar me kokë mensën. Po unë iu luta të më tregonte zyrat dhe ai më çoi te ndërtesa e vogël. Trokita në derën ku ishte shkruar «kryeinxhinieri» dhe, pasi e hapa, u ndodha përballë një djaloshi njëzetepesëvjeçar. Ai më zgjati dorën, më tregoi karrigen, pastaj i foli Pjetrit:

— Hajde arushë, ta ndezim njëherë!

— Do t'ju lë. Më duhet të ha darkë shpejt se kam rrugë, — tha buzagaz ai duke na përshëndetur të dy, mbylli derën. I thashë kryeinxhinierit kush isha dhe përse kisha vajtur.

— Me Pjetrin erdhe? — më pyeti ai sikur kjo të ishte gjëja më kryesore.

— Po.

— Është djalë i zoti dhe shpirt njeriu. Është shakaxhi i madh dhe i urtë, si një nuse, paçka se ne i themi «arushë». E di si i ka mbetur ky emër? S'e di. Pjetri është ndeshur me një ari. Nuk them se ishte ndonjë ari shumë i madh, po prapë ari qe. Dhe Pjetri e mundi.

Dhoma ku rrinim ishte e ngrohtë, ndonëse soba kishte kohë që ishte shuar. Siç dukej kryeinxhinieri e kishte mbyllur punën e asaj dite.

— Ngrihemi. Jam shumë i lodhur, — më tha duke buzëqeshur dhe më ra me dashuri shpatullave.

— Bisedojmë nesër, — tha ai.

Desha s'desha u ngrita.

— Nesër do të jesh i lirë, kryeinxhinier? — i thashë.

— Xhemal më quajnë, — tha ai sikur deshi të më thoshte «Mos më thirr më kryeinxhinier». Trupi i tij i brishtë, koka e vogël dhe e rrumbullakët, flokët kaçurrelë e shumë të zinj, sytë e kaltër e të kthjellët, shkurt, gjithçka e tij m'u duk në kontrast me natyrën e ashpër të këtij vendi. — Patjetër, — dhe më ra me dashuri supeve.

Ne u bëmë gati të dilnim nga zyra, kur dera u hap dhe hynë brenda dy djem të rinj në moshën e Xhemalit.

— Ismaili e Petriti, inxhinierë, — m'i prezantoi Xhemali ata. Dy të rinjtë hapën një hartë dhe e vunë në tavolinë. Seç i parashtruan Xhemalit. Sytë e Xhemalit, gjer atëherë të qetë, sikur u zgjuan dhe unë pashë në ta një dritë që nuk e kisha parë pak më parë. Ai diçka nisi t'u sqaronte shokëve. Madje filluan të grindeshin, po ai fliste çuditërisht i qetë dhe ngadalë, pa e ngritur zërin, ndonëse nuk ishte aspak në një mendje me ato që shprehnin kolegët e tij. Pas pak dy inxhinierët sikur u bindën dhe ne u bëmë gati për të dytën herë të dilnim. I pari

e hapi derën Xhemali. Era që ishte bërë dhe më e fortë solli frymën e saj të ftohtë deri në dhomë, dhe nga kjo Xhemali foli:

— Ku vete kështu, o shoku gazetar?!

— Jashtë, — thashë unë, ndonëse e kuptova se ku donte të dilte Xhemali me atë pyetje.

— Bën shumë ftohtë, — tha Ismaili.

— Po fillon dëbora, — tha Petriti.

— Petrit, një vrap në dhomë dhe merr peliçen e Sinanit, — foli Xhemali.

Sakaq Petriti mbylli derën dhe ne qëndruam në këmbë në pritje. Ai u kthye shpejt. Veshja peliçen dhe dolëm. Era sillte rrotull fjollat e para të dëborës.

— Pas dy orësh do ta mbushë, — tha me keqardhje Xhemali.

Duke ecur drejt mensës ne vështroam me shqetësim grykën e malit që sillte erën e ftohtë. Xhemali seç tha prapë ca fjalë, por era nuk na la që t'i dëgjonim. Ai u ndal te dera e mensës.

— Ke për të mbetur këtu.

— Dimri i madh të zëntë te miku i mirë, — thashë unë.

Qeshëm të katër dhe hymë në mensë. Në fund të saj ishte një stufë e madhe e sajuar me një fuçi. U ulëm në një tavolinë pranë saj.

— Do të marrim nga një raki, — tha Xhemali dhe u ngrit i pari që të priste biletën.

— Prit, — i tha Petriti duke e zënë prej peliçeje. Ai u ndal i habitur, por u habit ca më shumë kur Petriti nxori nga çanta një shishe njëlitërshe me raki.

— Ma ka sjellë axha. Etiketë nuk ka por ma merr mendja se është e fortë se ai të tillë përdor — tha Petriti.

Xhemali kapi shishen dhe e tundi, i hoqi tapën dhe piu nja dy gllënka:

— E fortë qenka! — tha duke rrudhur buzët.

Mua s'më besohej që ai me atë pamje prej çunaku ta ngrinte ashtu shishen e rakisë.

Ngritëm gotat e para dhe rakia na shijoi të gjithëve.

— Ore, po na pa xha Feti... — nuk e mbaroi fjalën Ismaili.

Nuk kaluan veçse disa çaste kur dera e kuzhinës u hap dhe u duk një plak tullac, i trashë, me bluzë e përparse të bardhë që po vinte drejt nesh.

— Xha Feti na përpiu, xha Feti na përpiu! — tha duke qeshur Ismaili dhe e fshehu shishen e rakisë.

— Është kuzhinieri, — më sqaroi Xhemali.

— Mos e fshih të shkretën, ta shoh si është, — tha plaku pa ardhur në tavolinë.

Ne qeshëm dhe Ismaili vuri shishen në tavolinë. Xha Feti e ngriti, piu disa gllënka dhe tha:

— A pa, pa! Qerrata raki qenka! Gëzuar djema!

— Gëzim paç, xha Feti, — e uruam plakun ne dhe trokitëm gotat me të.

— Të na kthehet shëndoshë Sinani, — tha ai dhe e ngriti prapë shishen.

— Shëndoshë ka për t'u kthyer se s'bën, — tha Petriti. Ata e përmendën dhe herë të tjera Sinanin, zunë në gojë dhe emrin e një vajze, Marie e quanin vajzën, po unë s'po kuptoja gjë. Unë nuk e dija kush ishte Sinani, ç'lidhje kishte midis tij dhe Maries, dhe të them të drejtën u bëra kurioz. Ma shtoi kuriozitetin shqetësimi që shprehu xha Feti për Sinanin. Vetëm tani u kujtova se kisha veshur peliçen e tij dhe mendova se ai do të ishte inxhinier. «Çfarë do të ketë veshur ai në këtë të ftohtë», — mendova unë pa u thelluar në gjërat e tjera, që patjetër ishin më të rëndësishme. Ne pimë ca si shumë dhe mua, nuk di nga rakia apo nga lodhja, gjithçka filloi të më mjegullohej e të më ngatërrohej si mos më keq.

— Ore, shokë, ç'bëheni merak për punën e Sinanit. E do vajza? E do. Edhe ai e do vajzën. Atëherë kush do t'i pengojë? Kanuni?

— Po ç'hyn kanuni këtu në minierë?! — foli Xhemali.

Nga fjalët e tij unë diçka kuptova se si qëndronte çështja e Sinanit me Marien dhe shkakun e shqetësimit të shokëve. Vërtet edhe mua m'u duk paradoksale që kanuni të vepronte edhe në minierë. Mbase kjo më vinte ngaqë kur vepronte kanuni, në vendin tonë nuk kishte miniera. Pastaj kanunin e krahasova me një urth gjigant që ka mbirë kudo dhe që mund ta takosh edhe në minierë. Ne ngritëm një shëndet për xha Fetion dhe unë, pa më thënë askush, piva një dopio me eks. Për pak çaste u shkëputa nga biseda që bëhej rreth tavolinës. Në përgjithësi rakia i bën njerëzit llafazanë, kurse mua më bën të heshtur e ëndërrimtar. Kisha hedhur sytë matanë dritares dhe shikoja fluturëzat e dëborës që binin mbi xham. Mua m'u kujtua se dikur kisha lexuar një vjershë ku poeti flokët e dëborës i quante flutura. Atëherë figura nuk më qe dukur e qëlluar, kurse tani gjeta një farë përngjasimi midis flokëve të dëborës që hidheshin e përdridheshin dhe fluturave. Flokët e dëborës binin në pikiadë drejt xhamit të dritares, pastaj ndërronin drejtim dhe binin diku gjetkë. «Si fluturat, — mendova unë, — që sulen lule më lule.»

— More, i thonë klasë punëtore këtu. Po të duan le të vijnë, — dëgjova një zë të fortë dhe një grusht u përplas në tavolinë. Ishte grushti i Xhemalit dhe zëri i tij.

U ngritëm vonë. Inxhinierët më morën për të fjetur në dhomën e tyre. Dhoma s'ishte e vogël dhe ishin futur në të katër shtretër, dy rafte të vogla me libra dhe soba. Petriti doli në oborr për të çarë dru, kurse Xhemali dhe Ismaili po ndiznin sobën.

— Këtu bën ftohtë, — tha Xhemali.

— Kemi nga katër batanije, mos do më? — më pyeti Ismaili.

Unë i thashë se më mjaftonin katër batanije. Nuk kishin kaluar më shumë se tri orë që kur kishte filluar dëborë, po tani trashësia e saj i kalonte 50 centimetrat. Nuk mund ta merrja me mend që për kaq orë të binte kaq shumë dëborë. Tani flokët e saj nuk mund t'i krahasoja më me fluturëzat, po me ca zogj të bardhë që binin nga qielli me një valle të pafundme drejt tokës.

Xhemali hapi një valixhe druri dhe nxori që andej gështenja. Poqëm gështenja mbi sobë dhe luajtëm shah. Vonë ramë të flinim. Unë rashë në krevatin e Sinanit. Gjumi më zuri shpejt. Duket ndihesha i lodhur. Nga mesi i natës më doli gjumi dhe u bëra, kur i thonë, esëll fare. Fillova të përpëlitesha në shtrat me qëllim që të flija përsëri dhe tamam kur ishte duke më zënë gjumi për herë të dytë, dikush hapi derën lehtë dhe hyri në dhomë. Iu afrua njërit krevat.

— Xhemal! Xhemal!

Xhemali vazhdonte të gërhinte dhe i ardhuri e luajti deri sa ai u zgjua.

— Kush je ti? — pyeti i përgjumur Xhemali.

— Jam Sinani!

— Sinani?! Po ç'të solli kështu, natën?

— E rrëmbeva! S'kisha ç'të bëja tjetër!

Unë u vura padashje në rolin e atij që përgjon.

— Ku është? — pyeti Xhemali.

— Pas derës. Nuk di ç'të bëj.

— I humbur paske qenë! Fute brenda, se po ngrin, — i mëshoi zërit Xhemali kësaj radhe. — Po prit, prit, — tha ai pas pak dhe na bërtiti neve që flinim: — Zgjohuni, shokë, se ashtu është puna! — Ai brofi i pari nga krevati dhe u vesh. U ngritëm edhe ne si të ishte dhënë alarmi.

Xhemali futi dru në sobë dhe i hodhi vajguri. Soba u ndez menjëherë. Pastaj në dhomë hynë Sinani me Marien. Vajza dukej që ishte nga fshati. Kishte veshur një triko leshi jeshile, një palë pantallona me kuadrate dhe asgjë tjetër. Në flokët e saj të drejtë e të gjatë si telat e sharkisë, dëbora filloi të shkrinte nga afshi i zjarrit. Dëbora në flokët e saj nuk ngjante as me fluturat, as me zogjtë e bardhë. Ajo tashmë ngjante me rruaza të vogla ngjyrë sadëfi që rrëshqisnin vazhdimisht nga flokët e saj të bukur dhe binin në supe e në dysheme.

— Si ndodhi? — i foli Xhemali Sinanit.

— Ja, siç e shikon! E rrëmbeva! As i ati, as të vëllezërit e as xhaxhallarët nuk deshën të ma jepnin. Atëherë unë i thashë Maries që të vinim në minierë sepse nuk kishim rrugë tjetër.

Xhemali uli sytë përdhe.

— Mirë bëre. Kur s'duan të binden... — i tha Sinanit pas pak.

— Mirë bëre, — aprovuam edhe ne.

— Hani, — u tha Sinanit e Maries Xhemali duke u treguar gështenjat e ngrohta.

— Nuk kemi ngrënë asgjë, — tha Sinani dhe mori gështenja i pari për t'i nxjerrë turpin edhe vajzës.

Edhe Maria filloi të hante pa drojtje. Soba u ndez mirë dhe gështenjat filluan të kërcisnin. Ndonëse të gjithë heshtnim, gjithësecili bluante përbrenda ç'do të ndodhte më vonë me këta të dy.

— Nuk di si do ta presin këtë gjë kushërinjtë e parë të Maries, — tha Sinani, që, ndonëse hante me uri gështenjat, mendja për asnjë çast s'i ndahej nga kjo që kishte ngjarë.

— Çfarë? — pyeti Xhemali.

— Maria ka dy kushërinj minatorë që punojnë me ne në zonën X, Mirashin e Markun, — sqaroi Sinani.

— Po po, i njoh, — vazhdoi Xhemali. — Pse, edhe ata janë kundër?

— Po. — Kësaj here foli Maria.

Biseda vazhdoi gjatë rreth sobës.

— Kështu që unë e Maria duhet të shkojmë në shtëpi. Të dielën ju presim në dasmë, — tha Sinani.

Të gjithë ramë në mendime. Të kapur nga i njëjti shqetësim, vështruam nga dritaret. Përjashta binte vazhdimisht dëborë. Secili nga ne e dinte se ishte shumë vësh-tirë të shkoje në qytet atë natë.

— Nuk kemi as Gazin këtu, — tha Xhemali.

— Veç Pjetri niset në këtë kohë, — tha Sinani.

— Pjetri është këtu, ai ka tranzitin, — tha Ismaili pa më lënë radhë ta thosha unë.

S'dinim ç'të thoshim. Ia kishim ngulur sytë Sinanit dhe prisnim të dëgjonim ç'do të thoshte ai.

Në këto çaste dëra u hap pa trokitur, gati me forcë. Ishte Pjetri.

— Hë, Pjetër, ç'kemi? — e pyeti Xhemali atë. — Ty të patëm në gojë. — Pjetri na hodhi një shikim të gjithëve me radhë. Veç meje, ai pa se në dhomë ndodhej edhe një vajzë, dhe siç dukej u pendua që kishte hyrë ashtu. Po tani kjo ishte bërë, ndaj më tha me zë të ulët:

— Orteku, te Lugu i Madh ka rënë orteku!

Xhemali u ngrit menjëherë në këmbë. Vura re se edhe inxhinierët e tjerë ishin ngritur dhe rrinin pak të hutuar. U ngritëm edhe unë e Maria. Diçka nga gjendja alarmuese e inxhinierëve na u injektua edhe neve. Xhemali, më i shkurtri dhe më i dobëti se të gjithë, kishte qëndruar në këmbë me sy të ngulur në një pikë. Ato çaste ai m'u duk si një strateg ushtarak që, pasi vlerëson situa-tën e krijuar, i duhet të marrë vendime të menjëhershme për të dalë nga gjendja.

— Ka bërë dëm? — pyeti ai, gjithnjë pa i lëvizur sytë.

— Jo. Ka zënë rrugën.

Inxhinierët morën frymë të lehtësuar.

— Rruga do të zihej edhe pa rënë orteku, me gjithë këtë dëborë që bie... — tha Petriti.

— Nuk ka ngricë. Me zinxhirë mund të kalohet, — tha Pjetri. Xhemali u vesh i pari. U veshëm edhe ne dhe i ramë pas. Me ne erdhi edhe Maria. U ndalëm para një ndërtese të vogël. Aty gjetëm edhe punëtorë të tjerë që merrnin kazma dhe lopata. Magazinieri i shpërndante veglat me një solemnitë të veçantë. Nuk dija në do të vinte edhe ai për t'u përleshur me ortekun e dëborës, po mua më dukej se ai që tani e kishte filluar këtë përleshje. Ai m'i hodhi sytë dhe e vuri re se isha njeri i huaj për minierën, po nuk më tha asnjë fjalë, veç më zgjati lopatën. Edhe Maria mori lopatë. Ai as për Marien nuk pyeti dhe nuk kërkoi sqarime. E gjithë kjo ishte një marrje veglash e shpejtë dhe disi nervoze, pa firma e porosira. Kur shkuam ne, puna për largimin e dëborës kishte filluar. Një masiv i tërë dëborë i ngjeshur kishte prerë rrugën mu aty ku ishin transhetë e betonuara. Pjesa më e madhe e ortekut kishte rënë në humnerë, poshtë xhadesë, në tërë gjatësinë e saj. Orteku kishte dëmtuar lugun ajror që shërbente për të derdhur materialin shterp. Filluam punën përkrah të tjerëve. Dëborën e ngjeshur në fillim e copëtonim, pastaj e hidhnim në humnerë. Kishte më tepër se një orë që po punonim. Ndonëse ishte ftohtë dhe era të thante, na rridhnin djersët rrëke. Maria punonte në një front më të lehtë, atje ku dëborë ishte më pak e ngjeshur. Mendimi i parë që formova për të ishte ky: ajo punonte si një burrë i fortë. «Maria duhet të ketë bërë shumë ditë pune, mbase punon për treqindtëshin», — mendova unë. Pranë saj punonte Sinani dhe pak më tej Petriti. Unë e Xhemali punonim pranë njëri-tjetrit.

— Kujdes, — më tha ai, — se shket shumë lehtë në

humnerë. Pas pak Petriti m'u afrua e më pëshpëriti diçka në vesh, që unë nuk munda ta dëgjoja.

— Hë, mo, i shikon apo jo? — më pyeti prapë ai.

Unë nuk dija se çfarë të shikoja.

— Nuk dëgjova se çfarë më the pak më parë, — i thashë atij.

— I shikon këta dy minatorët poshtë nesh?

— Po.

— Janë Mirashi e Marku. E shikon që po rrinë gjithë hundë e buzë? Kam frikë se mos ndodhë diçka, — tha ai.

— Ç'mund të ndodhë?

— Ja ku është humnera. Ata tani Sinanin dhe Marien i quajnë armiq.

Vura re se dy minatorët shikonin herë pas here me bisht të syrit Marien e Sinanin. Po në sytë e tyre nuk pashë asgjë armiqësore. Petriti ngulte këmbë që t'i thoshim edhe Xhemalit dhe çifti i ri të largohej nga ky vend pune e të shkonte të paktën më tej, në skarpatin e xhadesë. Duke biseduar, ne nuk vumë re një bllok të madh dëbore afër dy metro kub që u shkëput sipër skarpatit e u vërsul poshtë për në humnerë. Maria në atë çast po afronte dëborën afër humnerës. Duhej vetëm një shtytje e lehtë që vajza të mos dukej më... Ajo kishte kthyer shpinën dhe nuk shikonte asgjë. Gati si në ëndërr pamë Mirashin që u hodh me vrull përpara dhe i vuri gjoksin bllokut të dëborës. Dëbora e shtynte atë ngadalë drejt humnerës, por tashmë të gjithë e kuptuam se ç'po ndodhte. I thirrëm Marien dhe ajo klithi:

— Mirash! Mirash!

— Ik Marie, largohu! — bërtiti ai.

Vajza u shmang dhe ai e liroi bllokun e akullit i cili ra shpejt në humnerë. E gjithë kjo ndodhi sa çel e mbyll sytë dhe shumëkush nuk mundi as ta shikonte. Tashmë vajza qëndronte e hutuar para Mirashit.

— Mirash! — tha Maria dhe iu hodh në qafë.

Mirashi nuk lëvizi. Ai qëndronte në pozën e parë: me këmbë të hapura e të ngulura fort në dëborë, sikur po mbante akoma në gjoks peshën e madhe të dëborës. Maria po qante në gjoksin e tij. Minatori sikur u zbut dhe i hodhi dorën në qafë.

— Mos qaj, Marie, — tha thjesht ai.

— Nuk qaj për këtë, — tha vajza përmes lotëve.

Pranë tyre u afrua edhe Marku. Ai e përqafoi Marien dhe i tha:

— Përse qan? Kaq shumë u trembe?

— Nuk qaj për këtë... — tha vajza përmes lotëve..

— E di, e di, — tha Marku dhe tundi dorën sikur deshë të thoshte «Lëre tani, Marie, mos e zë në gojë atë që ka ndodhur». Ne u afruam pranë tyre. Sinani qëndronte disi mënjatë.

— Hajde, dhëndër, hajde, — i tha Mirashi atij.

Ai u afrua ngadalë dhe i druajtur, si nxënësi para mësuesit.

— Ne nuk deshëm, por tani... Edhe ti u ngute, — tha Mirashi.

— Mjaft tani, Mirash! U trashëgofshi — tha Marku.

— U trashëgofshi, — u tha dy të rinjve edhe Mirashi. Maria qeshi përmes lotëve.

Ndaj të gdhirë rruga u hap. Ne u nisëm për në minierë. Ecnim të gjithë bashkë. Tashmë Maria ecte midis Mirashit e Markut. Kur shkuam për të dorëzuar veglat, magazinieri na tha se një plak kërkonte një vajzë që kishte ardhur në minierë.

— A kishte pushkë? — pyeti Xhemali dhe vuri buzën në gaz.

— Jo, — tha disi i habitur magazinieri.

— Është axha, — tha Maria dhe me frikë iu afrua edhe më pranë Mirashit.

— Merremi ne vesh me axhën, — tha Mirashi dhe vuri buzën në gaz për t'i dhënë zemër Maries.

— Tani që nuk e ka marrë pushkën merrem vesh edhe unë, — bëri shaka Petriti.

Dhe tërë grupi, si një grumbull krushqish të gëzuar, u drejtuan për në mensë.

MËNGJES PRILLI

Ashtu, nëpër errësirë, të qeshurat gazmore të fëmijëve të fshatit vinin gjer tek unë. Rrëmuja e tyre bëhej gjithnjë e më e madhe. Trokisnin derë më derë me sa fuqi kishin e merrnin shokët dhe shoqet. I udhëhiqte Arshini, ai flokëkaçurreli që nuk i linte dy gurë bashkë. Po nuk ishin vetëm fëmijë. Aty kishte dhe të rinj e të reja gjashtëmbëdhjetëvjeçare. Po afrohej festa e pranverës dhe do të shkonin për të ndezur «zjarrin e madh», për të mbledhur lule dhe për të mbushur ujë në burime. Pastaj do të spërkasnin portat me ujë dhe do të vinin në to kurorat me lule. Kjo gjë bëhej pothuaj çdo natë, dy javë para ditës së festës. Unë nuk kisha shkuar asnjë natë me moshatarët e mi, s'më linin ata të shtëpisë. Isha djalë i vetëm pas një «tufe me motra», siç thoshin ata dhe kishin frikë se mos sëmuresha, sepse «peri këputet atje ku është më i hollë». Kështu më thoshte nëna, ndërsa babai s'e zgjaste fare. Po një natë iu luta aq shumë, sa që më në fund pranuan.

Dhe ja tani turma e tyre gazmore po vinte para shtëpisë sime.

— Dang,-dang-dang! — u ndien të trokiturat në derë.

U ngrita menjëherë dhe veshja pantallonat. Nëna u zgjua.

— Vërtet e ke vendosur të shkosh? — më pyeti ajo.

— Po!

— Do të copëtohesh kot së koti. Po nxitohesha për t'u veshur, por ashtu në gjysmerrësirë e kisha shumë të vështirë.

— Ndiz llambën, — më tha nëna.

— Ja, u vasha, — thashë dhe dola në hajat.

Zhurma e fëmijëve nuk dëgjohej më. «Të kenë ikur», — thashë unë me vete kur nuk dallova njeri dhe për një çast vendosa të kthehesha e t'ia këpusja prapë gjumit. Po shpejt në mugëtirë dallova një hije njeriu. Ishte Sofia, një vajzë nga lagjia e sipërme.

— Më tha Arshini të të pres, — tha ajo disi me turp.

— Nga shkuan ata, — thashë unë.

— Poshtë nga lumi.

U vumë në udhë. Ajo para dhe unë pas saj. Shikoja shtatin e derdhur të Sofies dhe habitesha që s'e kisha vënë re më parë se ajo ishte aq e bukur.

— Paskan mbërritur në meja, — tha ajo duke kthyer fytyrën nga unë. Pashë sytë e saj të bukur, flokët e gjatë e të drejtë, vetullat si hark. Rrugën e zgjidhte me kujdes, po në fakt ajo nuk mund të quhej rrugë. Kalo një gardh dhe hidhu në një stom, kapërce një vijë dhe ngjitu në një gur, ja, kështu vazhduam ne. Ishte natë dhe i gjithë peisazhi dukej i përhimë. Dalngadalë nata po largohej dhe dita po lindte. Ne ecnim në një pyll të vogël me lajthi. Të parat, ndër zogjtë, u zgjuan mëllenjat. I kisha dëgjuar edhe herë të tjera duke kënduar ato, po kurrë nuk më ishte dukur kënga e tyre aq e bukur. U ndala paksa që t'i vija veshin këngës së tyre.

— Mëllenjat, — tha Sofia kur e vuri re se unë ndalova.

— Këndojnë bukur, — i thashë.

— Ëhë, bukur, — tha edhe ajo, ndonëse e vura re se tha ashtu për të më bërë qejfin.

Nga pylli me lajthi vinte një erë e mirë, disi e athët. Kundërmimi i asaj ere m'u fut në gjoks dhe sikur ma zgjeroi kraharorin. Zgjata dorën dhe doja të kapja një gjethe lajthie. Duke shkëputur atë, dega u tund, mbi mua dhe Sofien ranë pikat e vesës.

— Po bie shi, — i thashë Sofies duke qeshur.

— Shiu i gjetheve dhe i pemëve, — tha ajo duke qeshur.

— Oh, çfarë shiu, — thashë unë dhe tunda edhe një degë tjetër.

— Këtu ka dhe lule qumështi. Të mbledhim, — tha vajza.

— Nuk shoh lule, — i thashë asaj.

— Këtë erë të mirë nuk e jep pylli i lajthive, por lulet e qumështit, — më shpjegoi Sofia.

Ajo u gërmua në tokë. Vura re se rrëzë tokës, afër rrënjëve të lajthive, kishte vërtet ca lule, të cilave, po t'u afroheshe, ua nuhasje më mirë aromën e këndshme të tyre, që të futej drejt e në gjoks.

— Unë i gjej nga era, — tha Sofia duke më zgjatur një tufë të vogël me lule qumështi. Ato lule ngjanin pak a shumë me vjollcat, por nuk ishin tamam si ato.

— E di përse u themi lule qumështi? — më pyeti ajo.

— Jo!

Tani ajo ishte pranë meje. Aroma e këndshme e luleve më dukej sikur buronte nga ajo. Sofia këputi një si syth nga lulja dhe ma futi me dorën e saj në gojë.

— Thithe!

Një lëng i hollë si qumësht më lagu buzën.

— Sa i ëmbël, — thashë.

— Tamam qumësht, — pohoi Sofia.

Unë ia mora tërë lulet asaj dhe fillova t'ia thithja. Mëngjesi po afronte dhe sendet po merrnin format dhe ngjyrat e tyre. Kaluam nëpër një livadh me lule shumë-

ngjyrëshe. Ndihej kundërmimi i tyre. Pylli me dushk ku u ngjitëm sapo ishte zgjuar. Këtë e ndiem nga kënga e zogjve.

— Cili zog këndon më bukur? — e pyeta Sofien.

— Edhe pyet?

— Përse të mos pyes?

— Po dihet! Bilbili! Ja si e përdredh zërin!

I vura veshin këngës së këtij zogu: «Fi-tcurr, fi-tcurr, fi, tcurr lju-lit, çoçoço-trre», — e ngrinte zërin ai. Unë gjer atëherë nuk e kisha dëgjuar me vëmendje këngën e bilbilit, nuk e kisha vlerësuar atë dhe më erdhi keq. Ç'është e vërteta unë pak rrija në fshat vetëm verës, sepse vazhdoja shkollën në qytet. Mbase edhe Sofia nuk e kishte dëgjuar me vëmendje, dhe e ka këtë mendim për këngën e bilbilit sepse kështu thonë më të rriturit, thashë me vete.

— Hë, Sofie, di të këndosh si bilbili? — e pyeta duke qeshur.

— Unë? Këngën e bilbilit e di përmendsh, — tha ajo. Pastaj bashkoi pëllëmbët para gjoksit dhe filloi të këndonte si bilbil. Në mugëllimin e dritës së mëngjesit sytë e saj shkëlqenin si yje të vogla. «Fi-tcurr-fi-tcurr-fi-tcurr-lju lit-çoçoço-trre», — bëri Sofia. Për herë të parë mendova se Sofia jo vetëm ishte e bukur, por kishte dhe një botë të brendshme të tillë.

— Sa bukur, — thashë unë me sinqeritet, kur ajo mbaroi së kënduari «këngën» e bilbilit.

U ngjitëm në majën e pyllit të dushkut. Që andej dukej lumi.

— O nënë, lumi! — klithi Sofia. Ajo vuri duart në gjoks si ato çaste kur imitoi bilbilin.

— S'e ke parë lumin? — e pyeta unë.

— Natën nuk e kam parë kurrë. Po tani nuk është dhe aq natë.

Vërtet lumi në atë kohë kishte një bukuri rrëqethëse.

Ai nuk ngjante me një lumë po me një fashë drite të lakuar. Ujërat e tij ishin të qeta, shumë të qeta. Nuk ndihej as llapashitja e valëve, veçse një zhaurimë e ëmbël që të ndillte gjumë. Të krijonte përfytyrimin e një pllake të madhe akulli që rrëshqiste gjithnjë. Po idenë se ai ishte lumë ta krijonin shelgjet që përkuleshin mbi valë. Nga përpjekjet e shelgjeve, uji lëshonte një «gërlluk-llëk» dhe ngrinte valëza të vogla.

— U vonuam. Nisemi se na presin shokët, — tha Sofia me një farë shqetësimi.

Vërtet atje, në majën e bregores, dëgjova Astritin që më thërriste:

— O Bujar, Jari!

— Ohooo! — iu përgjigja unë me sa fuqi pata.

— Hajdeni, ore!

U nisëm. Rruga shkante nëpërmjet një monopati të ngushtë, përmes një pylli të vogël me lajthi e dushk. Në pyll ishte errët. Sofia thua jse fluturonte dhe herë pas here më fshihej.

— Sofi, ku je, moj Sofi! — i thërrisja unë.

«Fi-tcurr-fi-tcurr...» — më përgjigjej ajo si bilbil.

Arritëm në majën e kodrës së bleruar, ku ishin mbledhur shokët e shoqet.

— Po ku ishit, mo? — na pyeti Arshini.

— Humbëm rrugën, — gënjeva unë.

— Mirë, shkoni tani e mblidhni krande. Secili duhet të sjellë pjesën e tij. Shikoni se ç'zjarr kemi bërë.

— Jarin fale, e kemi si mik, — tha Sofia.

— Nuk e fal, jo! Jari është shoku ynë, paçka se ka vajtur në shkollë, — tha Arshini, i bindur se kishte të drejtë.

Vështrimet e të tjerëve ranë mbi mua. Në to kishte një ndjenjë dhimbshurie.

— Mirë e ka, Arshini, — thashë unë. — Shkojmë, Sofi!

— Shkojmë, — tha edhe ajo.

Po shokët që kishin bërë shaka, ia plasën gazit.

U ulëm dhe ne pranë zjarrit. Ndihesha i lumtur sa s'bëhej, ndonëse frymëmarrja e shpeshtë fliste qartë për lodhjen time.

NGA PRAKTIKA PEDAGOGJIKE

Ishin javët e fundit të vitit shkollor. Pedagogu i pedagogjisë praktike lexonte emrat e studentëve të ndarë sipas grupeve dhe shkollat ku do të jepnim mësim. Pastaj pedagogu doli nga salla dhe studentët të gëzuar pyesnin njëri-tjetrin...

— Ku je ti, zushë Luli? — e pyeste me të qeshur Erminia Luljetën.

— Në «Petro Nini».

— Po ti?

— Në «Qemal Stafa».

Unë nuk po tregohesha dhe aq entuziazt. E kisha kryer detyrën e mësuesit për vite me radhë dhe tani s'më bënte përshtypje që do të jepja mësim. Isha tërhequr disi mënjanë dhe vështroja nga dritarja. Përjashta binte shi i imtë. Gjithmonë e kam dashur shiun, sidomos në pranverë. Në përgjithësi, ashtu si tërë fshatarët, rënien e shiut e shoh lidhur me tokën, me dëshirën për të pasur të korra të mbara. Toka tani ka nevojë për shi, sidomos gruri mendoja unë. Sa mirë sikur toka të ngopet me shi! Avullin ngrihet ugarëve! Vlaga e tokës...

— Dëgjo, o shurdh, — më shkëputi nga mendimet Mira. — Jemi në një grup bashkë.

— Mirë, — i thashë.

— Do të më ndihmosh të bëj plankonspektin. S'di gjë unë...

— Po të më presësh biletë për në kinema.

— Dakord, — thirri Mira entuziazte.

Pas një jave u paraqitëm në shkollat ku ishim caktuar. Në fillim do të vëzhgonim mësuesit. Unë, Mira dhe Faiku u ulëm në bangat e fundit. Më vonë erdhi edhe Ademi. Mësuesja e letërsisë ishte një grua e re, e bukur. Atë orë po shpjegonte De Radën.

— Sa bukur shpeguaka kjo mësuesja! Ç'kanë për t'u tallur nxënësit me ne, — tha Mira.

Ne të tjerët heshtëm.

— Hë, si t'u duk shpjegimi i mësueses, se ti ke qënë dhe vetë mësues, — më pyeti Mira kur dolëm në pushim të vogël në korridor. — Ajo ishte e sigurtë dhe të them të drejtën më pëlqeu.

— Nuk t'u duk pak teatrale ajo mësuese, — thashë unë.

Mira u deziluzionua. Në fytyrën e saj vura re një hije të lehtë trishtimi, që lidhej gjithnjë me ndonjë zhgënjim që pësonte «romantikja jonë», siç e quanim ne.

— Ti mendjemadh që mendjemadh mbete, — tha e nxehur ajo. Nuk i ktheva përgjigje. Ajo, në përgjithësi, ishte fanatike në pikëpamjet që mbronte. Në pushimin e gjatë dolëm jashtë. Mësuesja e letërsisë na u afrua me hap të lehtë dhe na tha:

— Si kaloi ora?

— Bukur, — i tha Mira.

— Mirë, — tha edhe Ademi.

Faiku heshtte. Mira m'i kishte ngulur sytë dhe më shihte si me frikë se mos unë do të flisja keq. Mbase unë vërtet nuk do të flisja keq, po të mos ishte bërë shkak vetë mësuesja.

— Unë dua mendimin e Yzeirit, — tha ajo, — se ky ka qënë mësues.

— Unë kisha një vërejtje, — i thashë mësueses.

Asaj iu pre buzëqeshja. U ndodh para një së papriture.

— Për shembull, — tha ajo duke buzëqeshur përsëri, po kësaj radhe në mënyrë të ftohtë, gati-gati ironike.

— Shpjegoni rrjedhshëm, qartë, deklamoni vargje, po megjithatë sikur nuk doli ajo që është thelbësore: përse De Rada mbetet i madh, i pavdekshëm.

— Mbase, — tha mësuesja. — Këtë nuk ma ka thënë asnjëri përveç jush. Mua më kanë vlerësuar të gjithë...

Nuk e zgjatëm. Me mësuesen u ndamë ftohtë. Edhe midis meje dhe shokëve të grupit ra një farë ftohtësie. Ecnim në heshtje. Asnjërit nuk i pëlqente ta prishte këtë heshtje. Po më në fund Mira nuk duroi.

— Përse fole ashtu? — më tha ajo.

— Fola ato që ndieja, që mendoja.

— Asgjë nga ato nuk ndieje e nuk mendoje, por ke maninë për të kundërshtuar, ke shpirtin e mohimit, — tha e nxehur Mira.

Edhe shokëve s'u kishte ardhur mirë.

— E ç'që nevoja t'ia thoshte, — tha papritur Faiku.

Ademi nuk foli. Edhe unë heshta. U përpoqa të mos nxehesha dhe deri në një farë shkalle ia arrita.

— Përse e fyejve kot mësuesen, — më tha kësaj here Mira.

— Unë ashtu mendoj.

— Ç'është e vërteta dhe unë s'u kënaqa, por mund të mos ia thoshe, — ma ktheu Ademi.

Kështu që atë ditë s'bëmë më fjalë por në heshtje u kthyem në konvikt.

Pa mbaruar javën e vëzhgimit mësuesja, kur mbaroi ora e gjashtë, na tha:

— Kemi një temë të bukur: arti i De Radës. Mendoj ta zhvillojë njëri nga ju. Kush do ta marrë?

Ne nuk folëm. Vështrimi i mësueses kaloi nëpër fy-

tyrat e shokëve dhe më gjatë ndali tek unë. Isha gati të pranoja menjëherë, po kisha frikë mos mendonin se kisha dëshirë t'i kundërvihesha mësueses. Natyrisht më shtynte të mendoja kështu zënka që kisha pasur me mësuesen dhe me Mirën.

— E merr ti, Yzeir? — më pyeti pas pak mësuesja. — Më duket se e do shumë De Radën. Do të më bëhej qejfi sikur... — Ajo nuk e mbaroi fjalën, po ne i nënkuptuam ato që s'u thanë.

— Mirë, — thashë unë.

— Nesër mos hajde, dhe përgatitu për pasnesër.

Shokët sikur u vendosën shpirtërisht pranë meje. Siç duket edhe ata nuk e panë gjë të mirë këmbënguljen e mësueses që unë të jepja mësim para se të na vinte koha për të dhënë, aq më tepër të flisja për artin e De Radës, për të cilin ne kishim bërë aq fjalë të pahijshme me njëri-tjetrin.

* * *

Ditën e shtunë orën e parë kisha për të dhënë letërsi. Shokët e mi dhe mësuesja zunë vend në bangat e fundit. Ndryshe nga ç'kisha menduar unë, emocionet ishin vërtet të mëdha. Fillova me kontrollin e dijes. Nuk pyeta mësuesen cilin nxënës të ngrija në mësim por ula stilografin në katrorët e regjistrit dhe thirra një emër:

— Katrina Sula!

Ishte një vajzë e bukur, që u ngrit në dërrasë me një buzëqeshje të lehtë në fytyrë. I drejtova pyetjen dhe ajo filloi të përgjigjej. Dëgjoja me kujdes, ndonëse vështrimin e kisha tretur përjashta. Kur ajo mbaroi së foluri, iu drejtova nxënësve:

— Ka ndonjëri vërejtje për përgjigjjen?

— Shumë mirë, — foli një nxënës nga banga e fun-

dit. Ishte një nxënës i rritur. — Fare në rregull, — mori zemër ai e foli prapë.

— Nuk është «fare në rregull», — thashë unë dhe fillova të plotësoja dhe të saktësoja përgjigjjen e Katrinës. E vlerësova me tetë. Ajo u përpoq të thoshte diçka por unë tani s'isha më i qetë dhe ajo me intuitë e kuptoi këtë, prandaj nuk e zgjati.

Fillova shpjegimin e mësimit. Që në fillim (për shkak të ndikimit dialektor) ngatërrova në të shqiptuar shkronjën ç me q. Nxënësit qeshën, qesha dhe unë.

— Fillojmë, — u thashë pas pak.

Kisha më se dhjetë minuta që flisja. U përpoqa të bëja një analizë të hollësishme të artit të De Radës. Mendimet e mia i ilustroja me fragmente të shumta nga vepra e De Radës. Zilja ra. «Vazhdojmë», — thanë nxënësit dhe unë për herë të parë gjatë asaj ore mësimi ndjeva një kënaqësi të madhe. Në fund solla disa qëndrime të reja të kritikës sonë ndaj një pjese të krijimtarisë së De Radës.

Si mbarova shpjegimin, u dhashë si detyrë që të lexonin disa shkrime të kritikëve tanë për poetin. Nxënësit nuk u larguan, edhe kur u thashë që ishin të lirë. Ata m'u afruan.

Pastaj mësuesja u tha të dilnin jashtë.

Tashmë rreth meje u afruan edhe shokët e mi. Në fytyrat e tyre vihej re kënaqësia.

— Ti e pe, — më tha mësuesja, — mësimi dështoi. Gjatë gjithë orës klasa shungulloi. Nxënësit e treguan haptas pakënaqësinë... Pastaj nuk di ku je bazuar në ato që the për artin e De Radës. Teksti nuk ka gjëra të tilla.

— Kam lexuar artikuj, edhe vetë kam menduar diçka, — i thashë.

— I ka aprovuar Ministria për t'ua dhënë nxënësve? Nuk i ka aprovuar. Kurse këtë, po, dhe rrahu me pëllëmbë tekstin e letërsisë.

— Tekstin nxënësit le ta lexojnë. Nuk ka gjë që Yzeiri u dha diçka më tepër, përkundrazi, — tha Ademi.

— Dhe nuk i tha keq, — foli me buzëqeshje dhe entuziazte Mira.

— Unë këtë njoh, — tha përsëri mësuesja duke na tundur tekstin para syve. — Ky është zyrtar, kurse ato janë mendime subjektive të njerëzve të veçantë.

Ajo, si tha një «ditën e mirë» nëpër dhëmbë, hyri në sallën e mësuesve duke na lënë në korridor.

— Kjo gjë vlen të diskutohet më gjatë. Në analizë do të thërrasim edhe pedagog Qaniun, — tha Faiku, kur pa se diskutimi hyri në një rrugë pa krye. Në ato çaste u hap dera dhe doli në korridor Elvira, drejtoresha e shkollës që na ftoi për të hyrë në sallën e mësuesve.

— Hajdeni, hyni brenda, pse rrini jashtë? Ju jeni e ardhmja, gjaku i ri.

ARTI I VËRTETË

Piktori i ri ishte ca i trishtuar. Puna e tij e fundit qe portreti i Heldës me të cilin mbroi diplomën. Tani ai nuk e kuptonte nga i vinte ky trishtim: nga largimi i Heldës apo nga përfundimi i shkollës. Mbase nga të dyja. Ai u njoh me vajzën një vit më parë. Ishte verë e piktori kishte ardhur për pushime në qytetin e lindjes. Në pallatin e tyre kishte ardhur një familje me të cilën familja e piktorit kishte vajtje e ardhje të mira. Kjo i dha mundësi atij të njihej me Heldën. Helda ishte e bukur, shumë e bukur! Kishte flokë të zinj, vetulla të zeza dhe ajo që qe e rrallë te Helda qenë sytë e kaltër. Piktori habitej se si një brune e theksuar të kishte sy aq të kaltër. Ai mendonte se ishte pikërisht kjo parregullësi, ose si të thuash ky përjashtim i natyrës që të ngjallte ndjenjën e së bukurës kur e shihte vajzën. Por ta vështroje thellë nuk ishte vetëm pamja e jashtme ajo që e kishte bërë për vete djaloshin. Ai kishte parë edhe vajza të tjera të bukura e nuk i kishin bërë atë përshtypje. Helda ishte kurdoherë e gëzuar dhe e qeshur, ishte shumë e çiltër. Këtë gëzim dhe çiltërsi ajo sikur ia injektonte çdo bashkëbiseduesi. Dhe piktori pikërisht për këtë kishte nevojë. Piktori vinte re se orët në shoqëri me Heldën kalonin pa u marrë vesh fare. Vendosi që për diplomë të përgatiste portretin e saj, po këtë gjë nuk ia zuri në gojë. Sa herë bëhej gati

të fliste për këtë, sikur e shtrëngonin një palë duar të fuqishme në fyt dhe ai nuk mund të nxirrte asnjë fjalë. Dalngadalë prania e saj filloi ta shqetësonte. Po ky ishte një shqetësim i ëmbël, që lidhej me mugëllimin e një ndjenje të re, disi të papërcaktuar. Një ditë ai mendoi se me vajzën nuk kishte thjesht shoqëri, por diçka më shumë. Kur arriti në këtë përfundim ai sikur u tremb. Ai vetëtimthi mendoi se vajza nuk i kishte dhënë as rastin më të vogël që ai të mendonte kështu. Brenda karakterit dhe temperamentit të saj ajo ishte treguar kurdoherë korrekte. Sidoqoftë mendimi që të bënte portretin e saj nuk i ndahej për asnjë çast gjersa një ditë, fare papritur i tha se kishte dëshirë t'i bënte një portret. Vajza pranoi.

Djaloshin e hutoi kjo befasi e këndshme. U gëzua si një fëmijë kur i lëshon në dorë një lodër që e ka kërkuar prej kohësh.

— Të falemi nderit, Helda!

Vajza, e çuditur nga ky falënderim, qeshi.

— Kur të fillojmë nga puna? — pyeti piktori.

— Kur të duash, — tha vajza.

Ata vendosën që të fillonin të nesërmen. Vajza pozonte me kënaqësi, pa u mërzhitur deri sa Arbeni i thoshte mbaruam për sot. Vajza qeshte dhe i hidhte sytë portretit. Përpiqej të hetonte se ç'gjë nga ajo ishte derdhur në pël-hurë. U mësuan shumë njëri me tjetrin dhe e prisnin me padurim orën për të filluar punën. Arbeni herë-herë mbyllte pak sytë dhe e vështronte vajzën në fytyrë. Atij sigurisht ia donte puna këtë gjë, po vajza nuk e mbante dot të qeshurën. Piktori ndërpriste punën dhe ndizte një cigare. «Hë, qesh tani, Helda», — thoshte ai dhe e sodiste vajzën përmes fjollave të tymit të duhanit. Këto ishin minutat më të këndshme për piktorin. Sa herë ai lodhej ose e kuptonte se nuk i shkonte puna mbarë, picërronte sytë dhe kundronte vajzën në fytyrë. Atëherë Helda qesh-

te dhe ai ndizte një cigare. Piktori e kuptonte se kështu thyhej disiplina artistike, por meqë kjo gjë e binte në humor dhe e ripërtërinte, përse të mos e lejonte. Sa e qeshur dhe gazmore ishte në bisedën e lirë, aq serioze ishte Helda gjatë kohës që ai punonte. Edhe kur lodhej, përpiquej që të mos e ndryshonte pozicionin. Po me kalimin e kohës piktori vuri re një ndryshim të Helda. Ajo nuk ishte më e gëzuar si në fillim, bile ai vuri re një farë lodhjeje dhe indiferentizmi në pozim. Arbeni tashmë nuk i picërronte sytë si më parë dhe vajza nuk qeshte... Në vend të shprehjes «Hë qesh tani, Helda», — që e përdorte dikur, ai thoshte «Pushojmë pak». Gjatë pushimit Helda rrallëherë bisedonte me piktorin dhe dukej më e mërzhitur se gjatë pozimit. Tani seancat bëheshin gjithnjë e më të shkurtra dhe puna ndërpritej shpesh. Një ditë, para se të fillonte punën, piktori i tha vajzës:

— Ti diçka ke, Helda. Dukesh ca e mërzhitur.

— Nuk kam gjë, — tha vajza.

Piktori e kuptoi se Helda nuk donte ta vazhdonte këtë bisedë ndaj dhe ai s'e zgjati më tej.

— Fillojmë, — tha, ndonëse kishte dëshirë të thoshte: «Kështu nuk mund të vazhdoj...» Mbase ai vërtet do t'i thoshte këto fjalë, por portreti pothuaj kishte përfunduar, duhej edhe pak punë. Në disa seanca Helda vinte me vonesë, në disa nuk vinte fare. Gjithnjë ajo i thoshte «më fal» piktorit, kurse ai i thoshte «s'ka gjë». Pas një seance, kur vajza shkoi në shtëpinë e saj, piktori mendoi se portreti tashmë kishte përfunduar. «Nuk kam çfarë t'i shtoj më. Sikur të jetë e domosdoshme që të punoj edhe më për të, atëherë kjo do të jetë një gjë e dështuar, sepse Helda ka ndryshuar krejtësisht. E fillova punën me një Heldë tjetër dhe po e përfundoj me një Heldë krejtësisht tjetër — tha ai përsëri dhe po atë ditë e lajmëroi vajzën se nuk qe nevoja të pozonte më mbasi portreti kishte përfunduar»

funduar. Ajo e priti me indiferentizëm këtë lajm. Atë, siç dukej, kishte kohë që nuk e interesonte më portreti.

Por portreti u vlerësua mirë nga komisioni. Arbeni u gëzua. Ai vetëm tani e kuptoi se kishte mundur të pasqyronte tërë botën e brendshme e të pasur të Heldës. Nga Helda e vrenjtur dhe e trishtuar portreti nuk kishte asgjë. Piktori buzëqeshi dhe iu kujtua një dialog i prindërve të vet, kur ishin në fshat. Ishte vjeshtë e tretë dhe kishte rënë shumë brymë, sa që vendi zbardhte sikur ta kishte lyer me një argjend. Një mëngjes ai dëgjoji nënën që i tha të atit «Paska rënë brymë e madhe si asnjë ditë tjetër». «Rrushin nuk e ka dëmtuar, se ai tani e ka pjekur dhe e ka forcuar kokrrën», — ia ktheu babai asaj. «Trishtimi i Heldës nuk e dëmtoi portretin, si ajo bryma që nuk e dëmtoi rrushin», — mendoi piktori. Kjo lidhje iu krijua nga dëshira për të bërë paralelizma.

...E gjithë kjo kishte ndodhur një vit më parë. Tani piktori kishte mbaruar fakultetin dhe priste emërimin. Helda nuk ishte më në qytet. Arbeni mësoi se ajo një vit më parë ishte dashuruar dhe kishte ikur në një qytet tjetër me një shofer, prindërit e saj e kishin kërcënuar dhe ishin përpjekur që ta martonin me një tjetër, po s'ia kishin dalë mbanë. Kjo kishte ndodhur vetëm dhjetë ditë pasi ai kishte përfunduar portretin e saj. Tani ai e shpjegonte shqetësimin dhe mërzinë e Heldës në ditët e fundit të pozimit të saj; kishte disa ditë në shtëpi dhe nuk i bëhej të kapte penel me dorë. Rrinte ca i mërziur dhe nuk e kuptonte nga i vinte kjo gjë: nga largimi i Heldës? Dëshira për të pikturuar e trondiste nga dita në ditë, por nuk gjente forca për të kapur penelin. Mendoi të shkonte disa javë në fshat, te tezja. «Atje mund të gjej ndonjë subjekt interesant», — vendosi më në fund.

— Kjo është dhoma jote, Arben, — i tha tezja.

Dhoma ishte e madhe dhe me tavan të lartë. Dritarja

e saj e madhe vështronte nga kopshti. Piktori vështroi nga dritarja dhe pa një shkallëzim të jashtëzakonshëm ngjyrash. Mu përtej kopshtit fillonte një livadh me lule shumëngjyrëshe, më tej livadhit shtrihej një kodrinë e vogël mbuluar me një bar kacavjerrës dhe, më në fund, pylli i gështenjave dhe ai i dushkut. Pastaj ai i hodhi një vështrim dhomës, e cila i pëlqeu mjaft; mbase ngaqë qe e bollshme dhe plot dritë. Piktori vuri re se orenditë nuk ishin në vendet e përshtatshme, prandaj ua ndryshoi pozicionin. Tërë natën fjeti me dritare hapur. U zgjua herët. Pa u veshur, ashtu në kanatiere, vuri duart në pezulin e dritares dhe ia nguli sytë sërish pyllit të bredhave. Atje ku fillonin majat fillonte dhe pylli i pishave i cili kishte një bukuri të madhe. Mu sipër pyllit ai e dinte se ishte një liqen i kaltër. Ai përfytyronte bukurinë fantastike të këtij liqeni malor. Lindja e diellit të korrikut sikur e përflaku pyllin duke zbuluar ca nuanca ngjyrash që nuk visheshin re më parë. Majat e pishave dhe të bredhave sikur kishin marrë flakë, hijet e tyre binin mbi dushqet e lajthitë duke sajuar një ngjyrë midis kafes dhe jeshiles, kurse kodrina, që gjer në atë çast dukej e bardhë, u bë laramane nga hijet e pyllit të bredhave. Mbase piktori do të kishte ndenjur shumë kohë në dritare sikur të mos e thërriste tezja, Lefteria, për të ngrënë mëngjesin.

— Të kam bërë vezë dhe kos. Të pëlqejnë?

— Mrekulli, — thirri djaloshi e filloi të hante me oreks të madh.

Pas mëngjesit ai i tha tezes se do të shkonte të shihte liqenin.

— Ai mban tri orë përpjetë, — i tha tezja.

— S'ka gjë, teze. Dua ta shoh, — tha disi me të lutur Arbeni.

— Prit të vijë xha Drizi nga stani e të shkoni bashkë ndonjë ditë tjetër. Ti as rrugën nuk e di, — u mundua të

arsyetonte Lefteria.

— Nuk më pritet, teze. Për rrugën mos u bëj merak se e gjej.

— Mirë, pra, — mirë, — tha tezja qejfprishur.

Arbeni u bë gati. Tezja i zgjati një trastë të vogël në dorë.

— Ke ca vezë, ca djath dhe një kavanoz me kos, — i tha ajo.

Djaloshi u zhduk në shtegun e gjelbër të pyllit.

Përfytyrimi i piktorit për bukurinë e liqenit malor nuk kishte qenë hiçgjë në krahasim me atë që po shikonte. Kur i doli përpara syve liqeni, ai u mahnit. Që nga maja e kodrës ku po vështronte, liqeni dukej si një sy i kaltër me qerpikë të blertë. Uji ishte krejt i kaltër dhe shumë i kulluar, rreth e qark liqenit kishte livadhe alpine me lule shumëngjyrëshe, pastaj rreth e rrotull, si shkallët e një amfiteatri gjigant lartësoheshin kodrat me pisha të gjata. Liqeni nuk ishte i thellë; kjo gjë dukej lehtë sepse në të kishin mbirë lule. Tani piktorit iu kujtua se diku kishte lexuar në gazetë për një liqen me lule. Ai kishte dëgjuar edhe një legjendë për të. «Pas vdekjes së Skënderbeut, turqit, ku me forcë dhe ku me dredhi, pushtuan vendin. Burrat e krahinës ku ndodhej liqeni, u vranë në përpjekje me turkun, kurse gratë u hodhën nga një shkëmb i lartë që të mos binin në duart e tij. Gjaku i tyre, — thoshte legjenda, — rrodhi dhe formoi këtë liqen të mbushur me lulëkuqe.» Piktori po vriste mendjen të kuptonte se përse i duheshin popullit legjendat. Dalngadalë legjenda u arratis nga mendja e piktorit dhe ai s'ngopej së pari liqenin e luleve. Kontakti me natyrën, me bukuritë e saj e përtëriu djaloshin dhe ai filloi të pikturonte peisazhe, të cilat i vendoste në dhomën e tij. Lefteria mburrej me djalin e së motrës dhe i ftonte kooperativistët që të vinin për të parë pikturat e tij. Kooperativistët vinin dhe mbe-

teshin të habitur para tablove. Ata i magjepste ngjashmëria me objektet e pikturuara. Atij vetë i pëlqente peisazhi për Liqenin e Luleve. Kur shikonte atë sikur ndiente fëshfëritjen e pishave, pëshpëritjen e valëve, sikur valët hapeshin dhe krijonin një hon dhe që andej dilte le gjenda...

* * *

Në mbarim të çdo jave Drizi, burri i Lefterisë, vinte në shtëpi «sa për të ndërruar teshat», siç thoshte ai. Drizi ishte çoban dhe jetonte me bagëtinë në mal. Ai vinte çdo të shtunë në mbrëmje dhe ikte të dielën pa u gdhirë mirë. Nuk kishte pasur mundësi të shikonte me nge as «ekspozitën», siç shprehej nganjëherë piktori. Po një të diel Drizi nuk u nis herët mbasi do të mbaronte disa punë në kryesi të kooperativës. Kur u bë gati për rrugë, po afrohej dreka. Arbeni iu lut të shihte pikturat e tij dhe Drizi u fut në dhomën e piktorit. Ai në fillim u çudit, dhe mahnitja shprehej shumë qartë në sytë e tij por më pas ndërroi, fytyra e tij nuk shprehte më asgjë. Arbeni po bëhej gati ta pyeste për pikturat se ç'përshtypje i kishin bërë, kur çobani tha:

— Bukur, bukur, po nuk shoh një fytyrë njeriu. Kemi kooperativistë të dalluar ne, pse s'merresh me to. Ja për shembull kemi Naken ne. Edhe disa gazetarë kanë ardhë dhe e kanë nxjerrë në gazetë atë. E di si është Nakja, o byrazer? Ti nuk e di po ja po ta them unë, ai është për kafshën si nëna për fëmijën. Nuk e mburr se e kam shok, por kështu është.

— Djalë, e bash i djalit, — tha Lefteria, që kishte hyrë në dhomë e habitur nga vonesa e tyre.

— Sa mban stani që këtu? — e pyeti piktori Drizin.

— Tri orë mban. Po është rrugë e bukur, kalon mes pishave, — tha Drizi.

Arbeni nuk dinte si t'i merrte këto fjalë, mos vallë kishte në to qortim?

— Do të vij dhe unë, — tha piktori i vendosur.

— Vërtet, — tha Drizi, — hajde nisemi se më vajti vonë. Lefteria nxitoi të thoshte:

— Drizi, nuk e nis çunin pa drekë unë! Ndalun edhe ti, të hamë drekë, pastaj nisuni.

— Po drekën e kemi me vete, moj grua. Te Kroji i Vashës ndalemi dhe hamë, — tha Drizi.

— Po teze. Unë pothuaj çdo ditë e kam marrë drekën me vete, — tha Arbeni.

— Mirë, pra si të duash, — i tha ajo Arbenit. Pastaj ajo iu kthye të shoqit:

— Drizi, mos ec siç e ke zakon, se do të lodhet çuni. Drizi qeshi dhe ata u nisën. Vërtet çobani ecte shpejt dhe Arbeni mezi e merrte mbrapa. Si mbaruan rrugën tërthore dhe iu ngjitën së përpjetës, Drizi e ngadalësoi hapin. Ai herë pas here kthente kokën prapa dhe pyeste djaloshin:

— Hë, u lodhe?

— U lodha ca, — përgjegjej çiltër piktori.

— Hë, se të bën mirë. Ju shkollarët s'para e mundoni veten.

— E, e, ia kthente piktori pa menduar të gjente fjalë të tjera për t'i thënë Drizit, sepse mendjen e kishte gjetkë. Ai përpiquej të përfytyronte Naken. «Duhet të ketë një fytyrë ekspresive», — mendoi ai. Në ato çaste për Naken mendonte edhe Drizi. Ai u kthye me vrull prapa dhe, sikur ta kishte lënë fjalën në mes, tha:

— E di ç'na ndodhi njëherë me Naken? U bë një konferencë për blektorinë në rreth, ku kishin ardhur blegtorë nga e gjithë Shqipëria. Ishim dhe unë, dhe Nakja.

Mbledhja mbaroi vonë dhe ne atë natë do të rrinim aty. Na kishin zënë vende në hotel që të flinim rehat. Shkuam në restorant që të hanim darkë. Na erdhi gjella dhe Nakja e fshiu pjatën menjëherë. «E paska marrë uria», — mendova unë, se s'e kisha parë atë që të hante aq shpejt. Unë haja ngadalë, pa u ngutur.

— Bjeri gojës, — më tha mua ai. — Se kështu flet Nakja: «Bjeri këmbës», thotë kur do që të ecësh shpejt, «Bjeri gojës», thotë, kur do që të hash shpejt.

— Ku do të shkojmë? — e pyeta unë.

— Në stan, te bagëtia, — thotë ai.

Po që të veje në stan duhej të ecje katër orë në këmbë, natën.

— Je në vete, — ia ktheva unë. Nakja nuk më foli veç më vështroi drejt e në sy. Nuk di a e kam kënduar mirë atë që shkruhej në sytë e tij, por ma merr mendja që ai në ato çaste kështu mendonte: «Si nuk më kupton, Drizi! Kur dhentë pjellin duhet t'u rrish mbi kokë. Ti je çoban dhe e di mirë këtë».

— Mirë, si të duash bëj. Unë po iki, — tha ai dhe u ngrit e doli përjashta, në errësirë.

Nakja atë që thotë s'e zgjat më. Isha i sigurtë se ai po nisej që atë çast. Hëngra dhe unë shpejt e shpejt dhe iu vura pas. Unë eci shpejt.

— Nake, na lodhe, — i thashë. Ai nuk u përgjigj.

— Dhentë nuk pjellin veç ditën por edhe natën, — më tha ai pas pak. — Ja, kot erdhëm, ka kaluar mesi i natës, — thashë prapë unë kur i qemë afruar stanit, që dukej i qetë. Po ai nuk po më dëgjonte. Hodhi gunën krahëve dhe u nis për në vathë. Nxitova edhe unë. Vërtet dhentë po pillnin njëra pas tjetrës. Ato që pillnin ne i veçonim nga të tjerat dhe u jepnim misër. Kur i veçuam të gjitha dhe i ushqyem, drita feksi në malin e Xhernit. Ishim shumë të lodhur dhe sytë na digjin për gjumë.

— Bëmë gjithë këtë punë. Po të kishim fjetur në hotel, akoma nuk do të ishim nisur, — i thashë unë. Ai nuk foli, veç qeshi.

Stanet u dukën. Drizi dhe piktori dredhuan përmes një rruge të ngushtë dhe arritën në stan. Para u doli një burrë rreth të tridhjetave, shpatullgjerë e gjoks leshtor. «Ky do të jetë Nakja» — tha me vete piktori. Po ai ishte Ademi. Pastaj nga stani doli plaku Hilë.

— Ku është Nakja? — pyeti dy çobenjtë Drizi.

— Në shtrungë, — tha Ademi.

Piktorin po e brente kureshtja për të parë Naken.

— Qerase djalin, — i tha plaku Hilë Ademit. Hila e kishte fjalën për piktorin. Ademi i mbushi djaloshit një pjatë me djathë të njomë. Piktori kishte ngrënë edhe një herë më një basho djathë të njomë po ky iu duk më i mirë.

— Provoje edhe këtë, — i tha Hila duke i zgjatur një pjatë alumini me kajmak.

— Faleminderit, u ngopa, — tha piktori.

— Provoje, provoje, — nguli këmbë Hila.

Piktori hëngri dy lugë pa mundur të hante të tretën. Hila qeshi.

— Është i fortë, — tha ai për kajmakun, sikur të bëhej fjalë për duhanin apo për rakinë.

Në këtë kohë hyri në stan Nakja.

— Mirë se erdhët, — i tha piktorit duke i zgjatur dorën.

— Mirë se ju gjeta, — tha piktori.

Ai ishte gabuar shumë në përfytyrimin e tij për Naken. Ai që kishte krijuar në mendjen e tij piktori nuk i ngjate fare Nakes që i qëndronte përpara. Se ky Nakja ishte trupvogël dhe i brishtë.

— Hilë, — iu drejtua ai plakut, — e qerase mikun?

— Me çfarë na u ndodh, — tha Hila.

— Por duhet menduar për darkën, — tha Nakja duke

vënë buzën në gaz, me një buzëqeshje shumë mikpritëse.

— Ky nuk besoj ta pijë rakinë, — tha Ademi për piktorin.

— E, ore, aty më rri ti. Këta të qytetit e pinë më shumë se ne, — tha plaku Hilë dhe u ngrit.

Piktori ndihej i lumtur dhe i dukej se njihej prej kohësh me këta njerëz kaq të çiltër e mikpritës ishin ata.

Mbrëmjen e kaluan mjaft gëzuar, sa piktori nuk mbante mend të kishte kaluar herë tjetër. U bënë tri-katër ditë që piktori po rrinte me çobenjtë. Ai ishte në humor të mirë. Jeta në bjeshkë po i pëlqente, po më shumë i pëlqenin njerëzit me të cilët jetonte. Një mëngjes, tek po shkonte së bashku me Naken në shtrungë, piktori e pyeti sikur ta njihte prej kohësh:

— A shkon ndonjëherë në shtëpi, o Nake?

— Një herë në dy javë, por tani kemi shumë punë sa edhe teshat për t'u ndërruar m'i bie vëllai.

Dhentë nga shtrunga i nxori Ademi dhe u nis për në bjeshkë.

— Jepu nga Begonjat sot, s'kanë shkelur prej kohësh andej, — i tha Nakja atij.

— Mirë, — tha Ademi dhe u hoqi dhenve përpara.

Nakja filloi të rregullonte shtrungën. Piktori rrinte pranë pishës që ishte afër shtrungës dhe vështronte me dashuri çobanin. Në punën e tij vërtet kishte pasion. Ai me kujdes pregatiste vendet për mjeljen e dhenve duke e ndarë shtrungën në trinat e vogla të thurrura me thupra shelgu. Pas një ore ai copë vend ngjante me një koshere të madhe blete. Nakja i lodhur dhe i djersitur hodhi gu-nën krahëve dhe ndezi një duhan.

— Sa halle ka gjëja e gjallë, — i tha ai piktorit.

Ata u nisën të dy bashkë për të shkuar te stani. U ulën paksa në hijen e një mani. Këtë man dikush duhet ta kishte mbjellë. Vërtet ai ishte rritur, bile bënte edhe

mana, por ata nuk kishin shijen e manave të zakonshëm. Kokrrat ishin shumë të tharta e të vogla. Nakja i hodhi piktorit qeskën prej plastmase me duhan «Sheldije».

— Mos do të ta dredh, — e pyeti ai djaloshin duke menduar se mbase nuk dinte ta dridhte cigaren.

— Jo, e dredh vetë, — tha piktori.

Po pinin cigaret e po vështronin bjeshkën.

— Ç'ka Drizi? Përse vrapon kështu? — pyeti piktori.

Nakja u pre në fytyrë. Ai e mendoi se Drizin ndonjë e keqe e shtynte të vraponte ashtu.

— Ka kafshuar gjarpri Bejkën, — tha Drizi duke u mbushur me frymë pas gjithë atij vrapit që kishte bërë.

Nakja u ngrit në këmbë dhe hodhi cigaren. Ai lëshoi brucën për tokë dhe mori vrapin tatëpjetë bjeshkës. Pas tij vrapuan edhe Drizi së bashku me piktorin. Piktori e mori me vështirësi atë të tatëpjetë, dhe kur arriti në vend, qe bërë qull në djersë. Nakja iu afrua deles së sëmurë.

— Në këmbën e parë — tha Ademi duke treguar vendin e kafshuar. Nakja u kërrus mbi dele dhe ia vërejti me kujdes këmbën. Vendi i kafshuar ishte enjtur.

— Tani e enjtura do të përhapet dhe delja do të... — nuk e mbaroi fjalën Ademi.

— Thikën, më jep thikën, — i tha Nakja atij.

Ademi i dha thikën. Të hutuar e të çuditur ishin edhe Drizi piktori.

— Mbajeni që të mos lëvizë, — u tha ai Ademit dhe Drizit.

Ata e mbërthyen delen njeri për brirësh, kurse tjetri nga këmbët e pasme. Nakja çau me thikë vendin e kafshuar nga gjarpri e, si shtrydhi fort plagën, — i vuri buzët. Ai po thithte helmin në trupin e deles.

— **Nake! Je në vete!** — bërtiti **Drizi dhe e lëshoi** delen. — Ti po merr më qafë veten për një dele, — iu hakërrua ai Nakes.

Piktori nuk e merrte dot me mend se si mund të bëhej një gjë e tillë për një kafshë.

— Është punë e rrezikshme, — tha ai pa iu drejtua askujt.

— Mba delen të them, — i foli ashpër Nakja Drizit.

Drizi e kapi përsëri delen. Balli i Nakes u mbulua me bula djerse. Edhe Ademi i shkonin djersët rrëke. Delja luante, përpëlitej nga dhimbja. Nakja vazhdonte i qetë punën; thithte helmin nga trupi i deles dhe e pështynte për tokë. Kjo punë vazhdoi gati një çerek ore. Pastaj ai e lidhi me një fasho këmbën e deles mu sipër plagës.

— Ik tani, Bejkë, — i tha ai deles me ëmbëlsi si t'i drejtohej një njeriu dhe e shtyu me dorë drejt tufës së dhurve. Delja u ngrit dhe në fillim u nis si me përtim, po pastaj e shpejtoi hapin dhe arriti tufën. Ata të katër nuk ia ndanin sytë. Kur delja u përzie me tufën, Nakja u ktheu shpinën çobenjve dhe piktorit dhe u nis andej nga kishte ardhur pak më parë. Ata që mbetën prapa tij nuk i thanë që të ndalej, as nuk vrapuan që ta arrinin. Ata nuk donin që t'ia shihnin sytë me lotë... Edhe Drizi e piktori u nisën për në stan. Piktori mbeti pak prapa Drizit. Në këto çaste atij do t'i pëlqente që të ecte vetëm, të mendonte, të mendonte... «Si më tha Drizi, — tha ai me vete, — ja për shembull kemi Naken ne...» Kështu më tha? Po, Kështu më tha! Ai kujtoi krijimet e tij që nga portreti i Heldës, peisazhet dhe... Ai akoma nuk e kishte filluar punën për portretin e Nakes, por do ta fillonte. E ndiente përbrenda me forcë goditjen, dëshirën e cila e ftonte të kapte penelin...

PËRMBAJTJA

RREMË SADRIA	3
HENDEKU KLASOR	14
FILIZI	25
NJERIU QË ÇALONTE NË ASFALT	35
ME SHËRBIM	43
NJË NATË PA GJUMË	52
MËNGJES PRILLI	67
NGA PRAKTIKA PEDAGOGJIKE	73
ARTI I VËRTETË	79